USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 40 (8241) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 10 tetor 2014

ANTIKORRUPSIONI

T'i japim fund diktaturës së korrupsionit të pamëshirshëm të drejtësisë

Fjala e Kryeministrit Edi Rama në forumin "Reformimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri"

Faqe 4-5

Intensifikimi i marrëdhënieve midis Forcave të Armatosura të të dy vendeve

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Poloni

Të dy ministrat e Mbrojtjes ranë dakord për nënshkrimin e një marrëveshjeje të re bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes

Faqe 2

CEREMONIA

Kthehet në atdhe ekipi këshillues ushtarak MAT "Striking Eagle-5"

Gjeneralmajor Bazo: Jemi krenarë për bashkëpunimin me SHBA, përkrah ushtarakëve amerikanë

faqe 3

ANALIZA

Ngritja në sistem e Mësimeve të Nxjerra për FA, pjekuri dhe maturi e Institucionit

faqe 6-7

NATO

Jens Stoltenberg: NATO do të mbrojë çdo aleat

faqe 9

BASHKËPUNIMI

Zhvillohet konferenca planëzuese e stërvitjes "Joni-2014"

faqe 4

BARTELS: ARSIMIMI MJAFT I RËNDËSISHËM NË TË ARDHMEN E NATO-S

"Ne jemi një Aleancë e fortë dhe e fuqishme ushtarako-politike"

Gjenerali Knud Bartels, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, një përkrahës i fortë i arsimimit ushtarak dhe kryetar i Bordit Këshillimor Akademik i Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, vizitoi Kolegjin e Luftës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara në Carlisle, Pensilvani dhe Kolegjin e Luftës së Trupave të Marinës...

faqe 8-9

SIGURIA

Partnerët e koalicionit dhe përgjegjësitë në luftën kundër ISIS

faqe 10-11

RRËFIMI

Të qenët Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s më 11 Shtator

faqe 12

OPINION

Të bashkuar kundër ISIS, të ndarë në fushëbetejë

faqe 14

FORCA TOKËSORE

Përfaqësues të kompanisë "NEXTER", prezantuan transportuesin e blinduar "TITUS", në Komandën e Forcës Tokësore

faqe 5

Intensifikimi i marrëdhënieve midis Forcave të Armatosura të të dy vendeve

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli vizitë zyrtare në Poloni

Tomasz Siemoniak: Roli i Shqipërisë, faktor stabiliteti në rajon

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli nga data 03 tetor 2014, ishte në Poloni në një vizitë zyrtare dy ditore me ftesë të zëvendëskryeministrit njëherësh ministër i Mbrojtjes i Polonisë, z. Tomasz Siemoniak. Vizita u bë në kuadër të një numri takimesh që ministrja Kodheli po bën në kufijtë lindorë të Aleancës.

Gjatë kësaj vizite, znj. Kodheli u prit në një takim nga ministri i Mbrojtjes së Polonisë, z. Tomasz Siemoniak. Ministrja Kodheli falënderoi homologun e saj Siemoniak për mbështetjen e Polonisë në integrimin e Shqipërisë në NATO dhe aspiratën për anëtarësim në Bashkimin Europian. Znj. Kodheli vlerësoi gjithashtu ndihmën e dhënë dhe njohjen nga Polonia të shtetit të ri të Kosovës, si dhe për integrimin e rajonit të Ballkanit.

Në këtë kontekst, ministri polak i Mbrojtjes, Tomasz Siemoniak vlerësoi rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon. Të dy ministrat shprehën nevojën e intensifikimit të marrëdhënieve midis Forcave të Armatosura të të dy vendeve tona në fushën e edukimit, stërvitjeve dhe bashkëpunimit me Forcat Speciale. Ata u ndalën gjithashtu edhe tek diskutimi i zhvillimeve të fundit gjeopolitike, si kriza në Ukrainë, zhvillimet në Irak e Siri dhe misioni Post-ISAF në Afganistan.

Të dy ministrat e Mbrojtjes ranë dakord për nënshkrimin e një marrëveshje të re bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes. Ministri polak, Tomasz Siemoniak pranoi me kënaqësi ftesën e bërë nga ministrja e Mbrojtjes, Kodheli për të vizituar Tiranën. Takimi i fundit në nivel ministrash mbrojtjeje mes dy vendeve daton në vitin 2003. Gjatë qëndrimit të saj në Varshavë, ministrja Kodheli vuri një kurorë tek Monumenti i Ushtarit të Panjohur në nderim të të rënëve.

Ndërsa në ditën e parë të vizitës, znj. Kodheli ndoqi nga afër stërvitjen "Anakonda 14", ku ishin të angazhuara 12500 trupa nga shumë shtete aleate. Ministrja e Mbrojtjes, Kodheli takoi edhe presidentin e Republikës së Polonisë, z. Bronisław Komorowski, shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Polonisë, gjenerallejtënant, Mieczysław Gocuł, si dhe shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura të Republikës Çeke, gjeneral Petr Pavel.

LIGJI

Qeveria miratoi vendimin për sigurimin e jetës së ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit.

Sipas këtij vendimi Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve, do të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2014. Në vendimin e Këshillit të Ministrave thuhet se "Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes".

Vendim i Këshillit të Ministrave, 8 tetor 2014:

V E N D I M

PËR

SIGURIMIN E JETËS SË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, QË DËRGOHEN NË MISIONE USHTARAKE JASHTË VENDIT, PËR VITIN 2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 6, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "c", të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me shoqërinë e sigurimeve "INSIG", sh.a., të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që dërgohen në misione ushtarake jashtë vendit, për vitin 2014.

Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe shoqëria e sigurimeve "INSIG", sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
EDI RAMA

STAFI

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Alba **MUSARAJ**

Redaktore korrektore:
Elona **SHIMAJ MAKO**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës

Afganistan: Ushtarakë të FA, kontribut në kuadër të misionit ISAF

Kthehet në atdhe ekipi këshillues ushtarak MAT "Striking Eagle-5"

Gjeneralmajor Bazo: Jemi krenarë për bashkëpunimin me SHBA, përkrah ushtarakëve amerikanë

Më datën 03 tetor 2014 paradite, u zhvillua, ceremonia e kthimit në atdhe të ekipit këshillues ushtarak të koduar MAT(Military Advisor Team-5) "Striking Eagle-5", me mision në Afganistan.

Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e forcave kryesore dhe atyre mbështetëse, drejtorë të drejtorive në SHPFA, prindër dhe të afërm të misionarëve, etj. Ceremonia është përshëndetur nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneral Bazo në fjalën e tij pasi i uroi së pari për ardhjen shëndosh e mirë pranë familjeve të tyre, ka falënderuar ekipin këshillues ushtarak për shërbimin që i kanë bërë atdheut, për kontributin e dhënë në kuadër të misionit ISAF, Afganistan. "Jemi krenarë për bashkëpunimin me SHBA, për besimin e madh që ka treguar ku trupat tona kanë kryer detyra përkrah ushtarakëve amerikanë. Të nderuar familjarë të misionarëve tanë! Dua të shpreh respektin për mbështetjen e dhënë nga ana juaj, mbështetje e cila bëri të mundur që misioni të sigurojë suksesin e radhës" ka nënvizuar ndër të tjera gjeneral Bazo.

Ceremonia është përshëndetur nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneral Bazo në fjalën e tij pasi i uroi së pari për ardhjen shëndosh e mirë pranë familjeve të tyre, ka falënderuar ekipin këshillues ushtarak për shërbimin që i kanë bërë atdheut, për kontributin e dhënë në kuadër të misionit ISAF, Afganistan.

Rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit e sigurisë nënujore

Zhvillohet konferenca planëzuese e stërvitjes "Joni-2014"

Në Komandën e Forcës Detare, në datën 06 tetor 2014, u zhvillua konferenca planëzuese për zhvillimin e stërvitjes të përbashkët "Joni-2014". Në të morën pjesë specialistë të Degës Operacionale dhe Stërvitjes në Forcë dhe Flotiljen Detare të Pashalimanit, zëvendëskomandanti i Qendrës Kombëtare së Zhytjes, kapitenlejtnant Laçe Hila dhe zëvendëskomandanti i Kompanisë të Batalionit të Forcave Speciale, kapiten Resul Fejzo. Konferenca u drejtua nga shefi i Shtabit i Forcës Detare, kapiten i rangut të II-të Adnand Agastra. Kapitenlejtnant Laçe Hila, në emër të grupit të punës, prezantoi drejtimin dhe qëllimin e stërvitjes, objektivat dhe detyrat e Forcave pjesëmarrëse, fazat e stërvitjes dhe afati kohor, rajonin e zhvillimit të stërvitjes, struktura e Task Forcës, skenarët, plani dhe mënyrat e zhvillimit, skema e komandimit dhe komunikimi. Stërvitja më e re e Forcës Detare "Joni-2014" do zhvillohet në rajonin e Gjiri të Pashalimanit me strukturë Task Force. Qëllimi kryesor i saj është rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit e sigurisë nënujore për kontrollin e anijeve, bankinave dhe moleve gjatë bregëzimit të anijeve në porte, gjire dhe vende të caktuara, si dhe rritja e shkallës së komandim-drejtimit dhe bashkëveprimit gjatë kryerjes së këtyre operacioneve. Stërvitja do të kalojë në tre faza, faza e parë është konferenca planëzuese, e dyta, zhvillimi i stërvitjes dhe faza e tretë konkluzionet. Në stërvitje krahas shtabit të FD, do të marrin pjesë mjete dhe personel nga Flotilja Detare e Pashalimanit, Batalioni i Forcave Speciale dhe Qendra Kombëtare e Zhytjeve, që në këtë stërvitje krijojnë një Task Force të Përbashkët. Mbas këtij prezantimi, pjesëmarrësit diskutuan për detaje dhe elemente të vendosjes së mjeteve e personelit, ekzekutimit praktik të tematikave e skenarëve, vendosja dhe akomodimi i pjesëmarrësve, mbulimi logjistik i stërvitjes, etj. Në vijim shefi i Shtabit të FD, kapiten i rangut të II-të Adnand Agastra theksoi rëndësinë e kësaj stërvitje me tematikë të veçantë, vlerësoi punën e deritanishme të grupit të punës dhe tërhoqi vëmendjen për përmirësimin e dokumentacionit të komandim-kontrollit, të masave të sigurisë, specifikimin e detyrave të Flotiljes, masat paraprake për rregullin e disiplinës gjatë zhvillimit të saj, të cilat janë dhe porosi të komandantit të FD, gjeneralbrigade Qemal Shkurti, përfundoi kapiten i rangut të II-të Agastra.

"JONI-2014"

Stërvitja më e re e Forcës Detare "Joni-2014" do zhvillohet në rajonin e Gjiri të Pashalimanit me strukturë Task Force. Qëllimi kryesor i saj është rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit e sigurisë nënujore për kontrollin e anijeve, bankinave dhe moleve gjatë bregëzimit të anijeve në porte, gjire dhe vende të caktuara, si dhe rritja e shkallës së komandim-drejtimit dhe bashkëveprimit gjatë kryerjes së këtyre operacioneve.

T'i japim fund diktaturës së korrupsionit të pamëshirshëm të drejtësisë

Fjala e Kryeministrit Edi Rama në forumin "Reformimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri"

Zoti President,
Zoti Kryetar i Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj,

Besoj që, nëse i hedhim një sy gjithë grafikëve të zhvillimit të jetës së këtij vendi në këto 20 vjet, një grafik, pa asnjë dyshim do të bënte dallim të madh nga gjithë të tjerët dhe që do të ishte grafiku i drejtësisë dhe i perceptimit të publikut për drejtësinë.

Janë afro 90% e shqiptarëve, - të cilët përgjithësisht janë shumë herë më të përafruar në qasjen ndaj çështjeve të tjera dhe të ndarë qartë, në përqindje shumë më të arsyeshme,- që besojnë se në Shqipëri nuk ka drejtësi dhe se sistemi i drejtësisë nuk funksion. Janë mbi 80% e shqiptarëve që, rregullisht kur pyeten, pohojnë se sistemi i drejtësisë është i korruptuar dhe se për të fituar një gjyq nuk ka fort rëndësi sesa ke të drejtë, por ka rëndësi në radhë të parë, sesa para ke për të paguar. Janë mbi 90% e shqiptarëve që rregullisht përgjigjen se duhet një reformë rrënjësore, një operacion rrënjësor për sistemin e drejtësisë dhe praktikisht për çrrënjosjen e kancerit që e ka mbërthyer sistemin e drejtësisë. E besoj se nuk e teproj, në qoftë se them se janë 100% e partnerëve ndërkombëtarë të Shqipërisë, e miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët nuk besojnë se në Shqipëri ka drejtësi dhe të cilët besojnë se drejtësia në Shqipëri është e korruptuar.

Nuk ka as më të voglin dyshim, që është e rrallë për një vend sot, një vend në mes të Europës për më tepër, që sa herë komentohet nga partnerët, sa herë komentohet nga opinionistë apo analistë të huaj, sa herë komentohet në gjuhë të huaj, komentohet si një vend me drejtësi thellësisht të korruptuar. Kam frikë se nuk gaboj nëse them se ata që ata na shohin sot, të mbledhur këtu, ne njerëzve të politikës dhe të drejtësisë, më shumë na perceptojnë si pjesë të problemit, sesa si pjesë të zgjidhjes. Flas për publikun e gjerë, që sinqerisht do të doja shumë që sot të merrte mesazhin se ka një vullnet të përbashkët dhe ka një ambicie të përbashkët që i kalon kufijtë e partive, që i kalon të gjitha dallimet mes nesh, për të operuar me kurajë këtë sistem kanceroz, por, pa dashur të jem pesimist, kam frikë se e kundërta është e vërtetë.

Sidoqoftë, ne erdhëm me shumë kënaqësi dhe me vullnet të plotë në këtë forum të organizuar nga Presidenti i Republikës. Madje, duke shtyrë në kohë Konferencën Kombëtare për Reformën

në Drejtësi, që po përgatisim në koordinim të plotë nga ana e Komisionit të Ligjeve. Pikërisht, sepse besuam dhe besojmë që rruga më e mirë për ta hapur këtë proces është kjo që ndërmarrim sëbashku këtu, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, të cilin dëshiroj ta falenderoj për këtë nismë dhe për gatishmërinë që një ide fillestare të tijën, për të mbledhur njerëzit e drejtësisë, e shtjelloi bashkërisht me Kryetarin e Kuvendit, për ta kthyer në një forum më të gjerë se kaq, ku njerëzit e drejtësisë dhe njerëzit e politikës të gjenden sëbashku dhe sëbashku të përpiqen të adresojnë problematikën e rëndë të sistemit.

Ne nuk mund të shikojmë gishtin, kur gishti tregon hënën. E kemi shumë të qartë që më shumë sesa një përpjekje e përbashkët për të adresuar një problem të madh, të përbashkët, kombëtar, përpjekja në vijimësi e viteve të fundit dhe posaçërisht e vitit të fundit ka qenë një përpjekje në dy drejtime të ndryshme. Nga njëra anë, përpjekja për të adresuar me ndjesinë e një emergjence të madhe kombëtare, problemin e rëndë të sistemit të drejtësisë dhe nga ana tjetër, përpjekja për të frenuar këtë adresim në emër të Kushtetutës, të ligjit, të lirive, të të drejtave, të gjitha këto nocione, pa as më të voglin diskutim, legjitime, por s'ka më keq sesa kur kthehen në nocione penguese, për atë që në fakt është problemi themelor që kemi sot, pavarësia e sistemit të drejtësisë nga Kushtetuta, pavarësia e sistemit të drejtësisë nga ligji, pavarësia e sistemit të drejtësisë nga çdo e drejtë dhe liri e njerëzve që nuk e marrin dot drejtësinë në dyert e gjykatave, në një vend ku drejtësia është mall që blihet dhe nuk

> *Sigurisht që nuk është një pozitë e lehtë, pozita e shumicës sonë, e dalë nga zgjedhje që, në radhë të parë në këndvështrimin tonë, kanë pasur shtysën për një Shqipëri të drejtë, në kushtet e një padrejtësie të kthyer në sistem vertikal në të gjitha nivelet dhe jo thjesht e vetëm tek prokuroria, gjykatat apo sistemi i drejtësisë në vetvete*

është e drejtë që të takon.

Dua të shfrytëzoj këtë rast, për të thënë se pa as më të voglin dyshim, ne kemi gjithë vullnetin ta adresojmë këtë problem dhe ta adresojmë sëbashku. Për më tepër, kemi fatin që nuk jemi vetëm në këtë ushtrim të vështirë, jashtëzakonisht të vështirë, por të domosdoshëm për t'ia dalë mbanë. Sepse kemi edhe asistencën e çmuar të komunitetit ndërkombëtar dhe posaçërisht të Bashkimit Europian përmes një ekspertize

shumë të kualifikuar dhe bazuar në një eksperiencë, që tanimë është një thesar për ne, që është eksperienca e vendeve që dolën nga rënia e perandorisë komuniste dhe që në rrugën drejt Bashkimit Europian iu nënshtruan reformave të thella në sistemin e tyre të drejtësisë.

Sigurisht që, kemi idetë tona për këtë reformë, kemi propozimet tona për t'i adresuar problemet e sistemit në 360 gradë, por padyshim, kjo, në radhë të parë, sipas nesh është një temë ku politika duhet të krijojë kushtet që të gjithë të mund të shprehen dhe të ndërveprojnë, ku politika duhet të krijojë kushtet që njerëzit e sistemit në radhë të parë, gjykatësit, prokurorët, avokatët, noterët, të gjithë me radhë të mund të shprehen dhe të ndërveprojnë. Padyshim, nga ana tjetër, në këtë ndërveprim, edhe ndërveprimi i gjithë aktorëve politikë ka vlerën e vetë, ndërkohë që prania e ekspertizës ndërkombëtare është një garanci, besojmë ne, për ta çuar procesin në rrugën e duhur, me vullnet dhe me kurajë.

Ky është vizioni ynë për metodën e kësaj reforme. Kjo nuk mund të jetë një reformë e njëanshme, por kur flasim për reformë gjithëpërfshirëse duhet të kemi parasysh në radhë të parë, njerëzit e sistemit dhe pastaj, sigurisht, edhe të gjitha forcat e përfshira në procesin politik. Në rast se ky takim vlen për diçka, vlen si një moment i shprehjes së vullnetit të mirë. Por nga ana tjetër jemi të gjithë dëshmitarë, se askujt, asnjëherë nuk i ka munguar as mundësia dhe nuk i kanë munguar as fjalët për ta shprehur vullnetin e mirë, në 20 vjet. Dhe ja ku kemi sot, ku s'ka më keq se asnjëherë tjetër në 20 vjet, kur vjen puna tek drejtësia dhe tek mënyra si funksion sistemi ynë i drejtësisë.

Tjetra që padyshim përbën sot një detyrim për të qenë sëbashku këtu në këtë tryezë, është e vërteta e madhe dhe e hidhur, por le të na shërbejë si një ilaç për t'u kuruar dhe për t'u zgjuar, se ta harrojmë të gjithë ne, sëbashku, që Bashkimi Europian e pranon Shqipërinë, me këtë sistem drejtësie. Ne mund të fshihemi pas Kushtetutës e mund t'i tregojmë njëri-tjetrit ligjet, e mund të bëhemi zëdhënësit më të zhurmshëm të lirive dhe të drejtave të gjykatësve të korruptuar dhe të anëtarëve të korruptuar të KLD-së, por kjo nuk do të na ndihmojë të shkojmë në Europë. Kjo vetëm do të ushqejë debatin shterpë mes nesh, ndërkohë që Bashkimi Europian, dyert nuk ka për të na i hapur kurrë, nëse ne nuk do provojmë dy gjëra themelore; E para, që drejtësia nuk është mall që shitet dhe që blihet dhe e dyta, se përpara ligjit jemi të gjithë të barabartë.

E fundit, sigurisht që nuk është një pozitë e lehtë, pozita e shumicës sonë, e dalë nga zgjedhje që, në radhë të parë në këndvështrimin tonë, kanë pasur shtysën për një Shqipëri të drejtë, në kushtet e një padrejtësie të kthyer në sistem vertikal në të gjitha nivelet dhe jo thjesht e vetëm tek prokuroria, gjykatat apo sistemi i drejtësisë në vetvete. E, ne që kemi këtë mandat jemi dhe shumë më të ndjeshëm, normalisht, ndaj gjithë reaksionit gjithmonë e më të madh të njerëzve të pakënaqur ndaj nesh, në radhë të parë, për mënyrën si funksionon sistemi i drejtësisë. Dua ta them shumë hapur, ne nuk kemi alibi dhe ne nuk do të kërkojmë alibi. Pa as më të voglin dyshim, ne në radhë të parë i detyrohemi atyre të cilët na kanë votuar për një Shqipëri më të drejtë dhe paralelisht me ta i detyrohemi gjeneratave të tjera të këtij

Pikërisht, sepse besuam dhe besojmë që rruga më e mirë për ta hapur këtë proces është kjo që ndërmarrim sëbashku këtu, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, të cilin dëshiroj ta falenderoj për këtë nismë dhe për gatishmërinë që një ide fillestare të tijën, për të mbledhur njerëzit e drejtësisë, e shtjelloi bashkërisht me Kryetarin e Kuvendit, për ta kthyer në një forum më të gjerë se kaq, ku njerëzit e drejtësisë dhe njerëzit e politikës të gjenden sëbashku dhe sëbashku të përpiqen të adresojnë problematikën e rëndë të sistemit.

vendi, që nuk meritojnë të mbeten jashtë dyerve të Bashkimit Europian se në Shqipëri ka një koorporatë që shet e blen drejtësinë; Koorporata e prokurorëve dhe e gjykatësve të korruptuar të këtij vendi. Kam parë sesi menjëherë ka reagime ndaj kësaj qasjeje dhe më vjen shumë keq, por kjo është e vërteta e hidhur e vendit tonë të përbashkët. Fakti që ka përjashtime është për të vënë duart në kokë dhe jo për të qenë të përmbajtur në shprehjen e kësaj të vërtete. Fakti që ka prokurorë dhe gjykatës të ndershëm, të cilët luftojnë përditë për të respektuar veten dhe profesionin e tyre, është për të vënë duart në kokë, se janë përjashtim që përforcon rregullin. Ndërkohë që, e vërteta e tmerrshme është që shqiptarët që nuk vijnë dot në këtë sallë, shqiptarët që nuk kanë dot asnjë akses nëpërmjet celularit tek asnjë lloj gjykate dhe tek asnjë lloj gjykatësi, nuk kanë shans të marrin të drejtën e pronës së tyre pa dhënë lekë, nuk kanë shans të marrin drejtësi për djalin e tyre të vrarë, apo vajzën e tyre të përdhunuar, por, përkundrazi, rivriten dhe ripërdhunohen në dyert e gjykatave. Ashtu sikundër vriten dhe përdhunohen nga kriminelë të lëshuar nga gjykatësit me para, për herë të dytë e për herë të tretë, njerëz të cilëve ne mund, duhet dhe do t'ua kursejmë jetën, duke ua nxirë jetën gjykatësve dhe prokurorëve që e kanë kthyer profesionin e tyre në një biznes, që është biznesi më i ulët që bëhet sot, në Shqipëri.

Kjo është e vërteta, sipas meje.

Duke i uruar sukses Konferencës, unë besoj se ky moment, për të cilën edhe një herë tjetër dhe jo formalisht i shpreh falënderim tim Presidentit të Republikës, është një moment për të filluar një proces. Një proces që do të vazhdojë pa pritur, si, pse, dale, ta shohim e ku e di unë se çfarë, të ulemi të gjithë sëbashku, rreth një tryeze dhe të provojmë me praninë tonë rreth asaj tryeze se e kemi seriozisht, pavarësisht se kush e thërret tryezën, pavarësisht se kush mendon çfarë. Të dalim nga kjo histori e tmerrshme e gjithë këtyre viteve, të paktën, me faqen e bardhë të kujt provoi ta përmbyste atë grafik që e kemi para syve të gjithë. Grafikun e perceptimit të opinionit publik ndaj sistemit të drejtësisë dhe e mënyrës së funksionimit të sistemit të drejtësisë në raport me liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Gjithçka tjetër në Shqipëri që mund të ketë një grafik ka ulje, ka ngritje, ka momente të këqija, ka momente më të mira dhe përgjithësisht, vetë Shqipëria, pavarësisht se ne kemi këndvështrimet tona, nuk është ajo që ishte para 20 vjetësh, në të gjitha aspektet, në raport me aspiratat e njerëzve. Ndërsa po të marrim aspiratën e njerëzve për Shqipërinë Europiane dhe drejtësinë e sotme, ne jemi jo më nën diktaturën e ideologjisë komuniste, por nën diktaturën e një korrupsioni të pamëshirshëm, që nuk pyet për askënd dhe për asgjë.

Faleminderit!

Burimi:
http://www.kryeministria.al/
06 tetor 2014

Përfaqësues të kompanisë "NEXTER", prezantuan transportuesin e blinduar "TITUS", në Komandën e FT

Modernizimi: Prezantohet transportuesi i blinduar "TITUS"

Në datë 07.10.2014, përfaqësuesit e kompanisë "NEXTER", Zoti Philippe David (Drejtor për zhvillimin e biznesit i kompanisë "NEXTER"), Zoti Michel Lautier (Shef i programit "TITUS") dhe Zonja Maud Antonicelli (Drejtoria e marrëdhënieve me jashtë e kompanisë "NEXTER"), zhvilluan një vizitë në Komandën e Forcës Tokësore, me qëllim prezantimin e transportuesit të blinduar "TITUS"

Përfaqësuesit e kompanisë u pritën në një takim të veçantë nga Komandanti i Forcës Tokësore, Gjeneral Major Zyber Dushku.Më pas takimi vijoi me një brifing të zhvilluar nga përfaqësuesit e kompanisë "NEXTER" rreth mjetit të blinduar "TITUS".

Në këtë brifing morën pjesë Shtabi i Forcës Tokësore dhe Shtabi i Batalionit të 2 të Këmbësorisë.

Ngritja në sistem e Mësimeve të Nxjerra për FA, pjekuri dhe maturi e Institucionit

Mësimet e nxjerra në Forcat e Armatosura

Njohja dhe pranimi i dështimeve dhe i sukseseve të individit dhe organizatës, çelësi i suksesit dhe mbijetesës në fushën ushtarake.

"Eksperienca është mësuesi më i vështirë. Në fillim jep provimin, pastaj të shpjegon mësimin"

Oskar Uajlldi, Shkrimtar, 1854-1900

Në thelbin e tyre, Mësimet e Nxjerra janë pjesë e natyrës njerëzore dhe e historisë së njerëzimit. Ato janë pjesë e zhvillimit të tij. Ato e kanë shoqëruar njeriun gjatë gjithë ekzistencës së tij. Nuk ka fushë të veprimtarisë njerëzore që ato të mos i shtrijnë efektet e tyre. Njeriu është një qenie e ndërgjegjshme që synon përmirësimin e vetvetes dhe të veprimtarisë së tij.

Çdo njeri mëson nga gabimet e bëra. Çdo njëri mëson edhe nga sukseset e veta. Po ashtu, çdo njeri mëson edhe nga gabimet dhe sukseset e të tjerëve. E njëjta gjë ndodh edhe me çdo organizatë shtetërore apo private; ato mësojnë nga gabimet dhe sukseset e tyre, por edhe nga gabimet dhe sukseset e organizatave të tjera.

Njohja dhe pranimi i dështimeve dhe sukseseve të individit dhe të organizatës është çelësi i suksesit dhe i mbijetesës në botën e zhvillimit e të konkurrencës, aq më shumë në fushën ushtarake. Analiza dhe korrigjimi i gabimeve si dhe adoptimi i formave të suksesshme të të tjerëve janë gjithashtu tipare të zhvillimit të institucioneve të shëndetshme. Historia e njerëzimit ka treguar që njerëzit dhe organizatat që nuk kanë ndryshuar për një kohë të gjatë e kanë pasur të vështirë të mbijetojnë. Ky është tashmë një postulat. Ka pasur me qindra e mijëra individë dhe organizata që kanë dështuar, po ashtu qindra e mijëra të tjerë që kanë pasur sukses. Cili është ndryshimi midis tyre?

Kanë mbijetuar ata individë dhe ato organizata që reagojnë shpejt si ndaj gabimeve të tyre dhe të të tjerëve, ashtu edhe ndaj sukseseve të tyre dhe të të tjerëve.

Të mësuarit nga gabimet dhe sukseset e vetvetes dhe të të tjerëve është një fenomen shumë kompleks. Sidomos kur bëhet fjalë për një organizatë, ai bëhet më i vështirë. Si i tillë, organizata duhet të adoptojë një sistem, i cili të përfshijë njerëzit, procedurat e veprimit dhe pajisjet që mund të përdoren për ta bërë sistemin funksional. Dhe që sistemi të bëhet funksional, drejtuesit e organizatës duhet të organizojnë dhe trajnojnë njerëzit, si pjesa më aktive e organizatës, për të kryer vëzhgime realiste, për të aplikuar përqasje analitike dhe për të propozuar përfundime logjike e rekomandime të argumentuara për vendimmarrje në interes të përmirësimit të punës së organizatës.

Ky mekanizëm magjik, që quhet "Lessons Learned", ka përcjellë edhe më parë veprimtaritë e Forcave të Armatosura, megjithëse për shkaqe të ndryshme ato kanë qenë spontane dhe jo të organizuara në sistem.

Ngritja në sistem e Mësimeve të Nxjerra për një Forcë të Armatosur është shprehja e pjekurisë, e shëndetit dhe e maturisë së institucionit që ato përfaqësojnë. Ky sistemë shtë tipari dallues kryesor për ushtritë me koncepte të avancuara; ai është pjesë e konceptit të transformimit të Aleancës, për të reaguar e ndryshuar më shpejt se kundërshtari në spektrin simetrik dhe asimetrik. Si i tillë, Mësimet e Nxjerra do të shfrytëzohen në maksimum për të rritur cilësinë e perfomancës së njësive të FA në operacione brenda dhe jashtë vendit.

Sa më sipër, fenomeni i Mësimeve të Nxjerra ka karakter universal; ai përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore apo institucionale. Fokusi kryesor i sistemit të MN do të jenë misionet dhe operacionet e njësive të FA, brenda dhe jashtë vendit, stërvitjet dhe aktivitetet stërvitore e trajnuese apo vlerësuese të tyre. Kjo fushë veprimtarie e MN përbën një përqasje me rëndësi vendimtare; ajo ka të bëjë jo thjesht me dështim apo sukses të një aktiviteti e biznesi të kohëpaqes, por me dështimin apo suksesin e betejës, si dhe me humbjen apo shpëtimin e jetës së njerëzve. Në interes të zhvillimit të një sistemi funksional MN në FA, në kuadrin e bashkëpunimit me Aleancën, kemi tashmë të miratuar një Plan Veprimi me dy Komandat Strategjike të saj, të drejtuar nga Komanda e NATO-s për Transformimin (ACT). Një nga 6 fushat e këtij Plani afatmesëm është fokusuar mbi Mësimet e Nxjerra. Në këtë kuadër, janë parashikuar i gjithë spektri i veprimtarive të përbashkëta për ngritjen dhe konsolidimin e këtij sistemi në FA. Po ashtu, parashikohen veprimtari konkrete me JALLC (Joint Analysis and Lessons Learned Center) të NATO-s si dhe veprimtari të tjera dypalëshe me vende që e kanë sistemin MN në fazë më të zhvilluar. Thembra e Akilit e sistemit MN janë njerëzit: oficerët, nënoficerët, ushtarët profesionistë dhe civilët në FA. Sistemi nuk mund të funksionojë pa veprimtarinë aktive të tyre. Janë ata që mund ta bëjnë sistemin të suksesshëm, por janë gjithashtu ata që mund ta bëjnë sistemin të dështojë. Për këtë qëllim, një kujdes i veçantë do t'i kushtohet trajnimit të personelit që do të përfshihet në sistemin MN sidomos trajnimit të trajnuesve.

MËSIMDHËNIA

fenomeni i Mësimeve të Nxjerra ka karakter universal; ai përfshin të gjitha fushat e veprimtarisë njerëzore apo institucionale. Fokusi kryesor i sistemit të MN do të jenë misionet dhe operacionet e njësive të FA, brenda dhe jashtë vendit, stërvitjet dhe aktivitetet stërvitore e trajnuese apo vlerësuese të tyre. Kjo fushë veprimtarie e MN përbën një përqasje me rëndësi vendimtare; ajo ka të bëjë jo thjesht me dështim apo sukses të një aktiviteti e biznesi të kohëpaqes, por me dështimin apo suksesin e betejës, si dhe me humbjen apo shpëtimin e jetës së njerëzve.

Në mënyrë të veçantë, komandantët e të gjitha niveleve janë çelësi i suksesit apo i dështimit të sistemit të Mësimeve të Nxjerra. Ata kanë si autoritetin, ashtu edhe përgjegjësinë për të bërë funksional sistemin MN në njësitë e tyre, bazuar në paketën e dokumenteve të sistemit MN. Mësimet e nxjerra nuk kërkojnë personel të veçantë në njësi, ato janë pjesë e përshkrimit të punës së personelit të drejtorisë, degës, seksionit që mbulon operacionet dhe stërvitjen në hierarkinë e komandim-drejtimit të FA (J3/J7, G3, G7, S3/N3/A3).

Një element tepër i rëndësishëm për suksesin e sistemit MN është zgjerimi i komunitetit me njohuri, kulturë e ekspertizë për sistemin

MN nëpërmjet përfshirjes në kurrikulat e AFA, ANO, Shkollës së Trupës, etj., të moduleve specifike për sistemin e MN, të cilat kanë filluar e vazhdojnë që nga viti akademik 2009-2010.

Trajnimi për sistemin MN synon të zhvillojë te çdo ushtar profesionist, nënoficer dhe oficer një kulturë të re në përputhje me nivelin e tyre. Sistemi i MN kërkon qëndrim aktiv të tyre në rolin e vëzhguesit, grumbulluesit, analistit dhe vendimmarrësit. Në mënyrë të veçantë, niveli i komandantit dhe i oficerit të shtabit duhet të pajisen me të gjitha njohuritë për të zbatuar në mënyrë krijuese sistemin MN në njësi.

Sistemi i Mësimeve të Nxjerra kërkon shfrytëzimin në maksimum të teknologjisë së informacionit, të shkëmbimit të informacionit online, për të dhënë dhe për të marrë informacion që mund të përbëjë të dhëna për t'u përpunuar dhe analizuar. Në perspektivë, duke qenë se ne do të vazhdojmë të jemi pjesë e operacioneve ndërkombëtare të drejtuara nga NATO/BE/OKB, ushtarakët tanë do të shkëmbejnë informacion edhe me rrjetet e sistemeve MN të aleatëve të NATO-s, sepse një nga parimet themelore të sistemit MN është shfrytëzimi i mësimeve të nxjerra të të tjerëve, në mënyrë që ne të mos përsërisim gabimet e tyre ose ata të mos përsërisin gabimet tona. Kjo do të thotë që ushtarakët e të gjitha gradave të jenë në gjendje të përdorin rrjetin tonë të ardhshëm të mësimeve të nxjerra, si dhe ato të vendeve aleate, sidomos rrjetin e mësimeve të nxjerra të JALLC-ut të NATO-s.

Forcat e Armatosura kanë një Qendër të Doktrinës, e cila ka një Degë e Zhvillimit të Konceptit dhe Mësimeve të Nxjerra. Analiza e të gjithë fakteve dhe të dhënave të grumbulluara nëpërmjet sistemit do të analizohen nga kjo Degë, e cila synon të rrisë aftësinë analitike sipas eksperiencës më të mirë të NATO-s. QD në KDS është e hapur për të gjithë ushtarakët e FA që duan të japin apo të marrin informacion për sistemin e MN.

Burimi: Manuali i Mësimeve të Nxjerra në FA (MAFA-30)

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tregon solidaritetin e Aleancës në Turqi

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u takua më 9 tetor në Ankara me ministrin e Jashtëm, Mevlüt Çavuşoğlu dhe tha se erdhi për të dëgjuar pikëpamjet, përpjekjet dhe shqetësimet për situatën në rajonin e Turqisë. Në fillim të udhëtimit të tij të dytë si Sekretar Mbrojtjeje, Stoltenberg mbajti një konferencë të përbashkët për shtyp me ministrin e Jashtëm, Çavuşoğlu dhe tha se NATO po monitorin nga afër ngjarjet pranë kufirit jugor të Turqisë. "ISIL përbën një kërcënim të madh për popullin irakian, për popullin sirian, për rajonin më gjerë dhe të kombeve të NATO-s. "Pra, është e rëndësishme që e gjithë bashkësia ndërkombëtare të qëndrojë e bashkuar në këtë përpjekje afatgjatë. Unë i mirëpres vendimet e marra nga Shtetet e Bashkuara me shumë aleatë e partnerë dhe mirëpres votimin e fundit në Parlamentin Turk për një rol më aktiv të Turqisë në lidhje me krizën". Stoltenberg tha se NATO po luan rolin e saj në mbrojtje të territorit e popullsisë turke kundër sulmeve raketore. "Dislokimi ynë Patriot përforcon mbrojtjen ajrore të Turqisë. NATO është e gatshme për të mbështetur të gjithë aleatët në mbrojtje të sigurisë së tyre". Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s vlerësoi rolin e Turqisë si aleate të patundur që kontribuon në mbrojtjen kolektive të Aleancës dhe në stabilitetin e rajonit si dhe kontributin e Turqisë në Kosovë dhe Afganistan. "Ne do të vazhdojmë të mbështetemi te Turqia në lidhje me Afganistanin. Vitin e ardhshëm, ju do të jeni një prej vendeve të kuadrit si pjesë e misionit tonë të ri të trajnimit, këshillimit dhe ndihmës ndaj forcave afgane e po punojmë së bashku që misioni i ri të fillojë më 1 janar, siç është planifikuar". Stoltenberg tha se aleatët morën vendime të rëndësishme në samitin e Uellsit e tani po i kthejnë këto vendime në realitet. "Kështu që mezi pres të vazhdoj punën me Turqinë për ta mbajtur NATO-n themelin tonë të sigurisë", shtoi ai. Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralin Nexhdet Ozel. Ai u takua dhe me presidentin Erdogan, kryeministrin Davutoglu, ministrin e Mbrojtjes, Yilmaz dhe zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë.

Bartels: Arsimimi mjaft i rëndësishëm në të ardhmen e NATO-s dhe transformimin i saj

"Ne jemi një Aleancë e fortë dhe e fuqishme ushtarako-politike"

Gjenerali Knud Bartels, kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s, një përkrahës i fortë i arsimimit ushtarak dhe kryetar i Bordit Këshillimor Akademik i Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, vizitoi Kolegjin e Luftës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara në Carlisle, Pensilvani dhe Kolegjin e Luftës së Trupave të Marinës, Quantico, Virxhinia, gjatë turit të tij në Shtetet e Bashkuara nga 30 shtatori-3 tetori 2014.

Gjatë vizitës në Kolegjin e Luftës të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (UAWC), gjenerali Bartels u prit nga komandanti i UAWC, gjeneralmajor William E. Rapp. Kryetarit, të diplomuar nga Programi Ndërkombëtar i të Rinjve (IF) UAWC i vitit 1994, iu dha mundësia teksa vizitonte Kolegjin, të jepte një leksion në UAWC, i cili u fokusua në sfidat strategjike me të cilat përballet NATO nga pikëpamja e tij si kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s.

Gjatë leksionit të tij, gjenerali Bartels theksoi se sa i rëndësishëm është arsimimi në të ardhmen e NATO-s dhe transformimit të saj. Kryetari u shpreh: "Nëse ju nuk kuptoni se çfarë u krijua nga ndryshimet dramatike që pasuan Luftën e parë Botërore, nuk do të kuptoni atë që po ndodh sot…". Gjithashtu, ai foli se sa të rëndësishëm janë mësimet e nxjerra gjatë fushatës ISAF dhe sa e rëndësishme është puna që aleatët dhe partnerët kanë bërë së bashku duke mundësuar që NATO të ndërtojë një rrjet të gjerë bashkëpunimi sigurie.

Ndërkohë në UAWC, kryetari u nderua kur u paraqit në IF në Hall of Fame nga komandanti i UAWC, gjeneralmajor William E. Rapp. Hall of Fame u themelua për të nderuar të diplomuarit UAWC IF, që kanë marrë pozitën më të lartë në Forcat e tyre të Armatosura ose në një organizatë ndërkombëtare.

Në Universitetin e Trupave të Marinës në Quantico, gjenerali Bartels u takua me gjeneralbrigade komandantin Thomas D. Weidley dhe ish-komandantin e ISAF-it, gjeneralin Dunford e dhanë një leksion për studentët mbi të ardhmen e NATO-s. Kryetari u impresionua nga studentët dhe stafi, ku duke folur rreth sjelljes së ardhshme strategjike të NATO-s, e cila ka nevojë për ndryshime, nuk do të funksionojë pa stërvitje, trajnime, testime dhe vlerësime. Duke përfunduar ligjëratën e tij, gjenerali Bartels tha rreth NATO-s: "Ne jemi një Aleancë e fortë dhe e fuqishme ushtarako-politike dhe ne bëjmë ndryshimin, ne e kemi bërë një ndryshim dhe mund ta bëjmë përsëri një të tillë në të ardhmen nëse duam".

Bartels diskuton arkitekturën e sigurisë euroatlantike dhe rëndësinë e një lidhjeje të fortë transatlantike

Gjenerali Knud Bartels, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, vizitoi Pentagonin dhe u takua me gjeneralin Martin E. Dempsey, kryetar i shefave të Përbashkët të Shtabit, shefave të Shërbimit dhe zyrtarëve nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara gjatë vizitës së tij në Shtetet e Bashkuara. Takimi me gjeneralin Dempsey dhe shefave të përbashkët të Shtabit ishte një mundësi për t'u angazhuar në një diskutim të hapur e të sinqertë lidhur me çështjet e NATO-s dhe zbatimin e vendimeve të marra nga krerët e Shteteve dhe Qeverive gjatë samitit të Uellsit. Gjithashtu, gjatë takimit të tij, kryetari shprehu se si ai i mirëpret dislokimin e trupave amerikane dhe njësinë e blinduar të kalorësisë, gjatë tre Shteteve Baltike dhe Polonisë, një demonstrim i dukshëm i angazhimit amerikan në anëtarët e pjesës lindore të Aleancës dhe në sigurinë euroatlantike.

Gjatë vizitës së tij në Pentagon, gjeneralit iu dha çmimi "Legjioni i Meritës" nga gjeneral Dempsey si vlerësim i sjelljes së tij të jashtëzakonshme tek shërbente si shef i Mbrojtjes i Forcave së Armatosura Daneze (2009-2011) dhe si kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s. Gjenerali Bartels, teksa pranonte çmimin, tha: "Unë jam i nderuar që marr këtë medalje, të cilën e pranoj në emër të të gjithë burrave e grave në operacione".

Gjithashtu, kryetari u takua dhe me zëvendëssekretarin e Mbrojtjes, të nderuarin Robert Work dhe zëvendëssekretaren e Shtetit, Victoria Nuland. Ndërsa në Uashington D.C. gjatë mbledhjes, gjenerali Bartels shpalosi prioritetet e tij kryesore si kryetar i Komitetit Ushtarak. Këto prioritete përfshijnë zbatimin dhe ruajtjen e rotacionit së forcave aleate në një bazë të vazhdueshme në Vendet Baltike dhe Poloni dhe përshtatjes së NATO-s me një arkitekturë të re sigurie pas shkeljes së integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës nga ana e Rusisë. NATO nuk e njeh dhe nuk do ta njohë aneksimin ilegal të Krimesë nga ana e Rusisë.

Ndërkohë që ishte në Uashington D.C., gjenerali Bartels shfrytëzoi rastin për të vizituar Varrezat Kombëtare Arlington, ku bëri homazhe për të gjithë ushtarakët e rënë amerikanë, duke vendosur një kurorë në Varrin e Ushtarit të Panjohur. Pas ceremonisë, kryetari bëri një tur në Dhomën e Amfiteatrit Përkujtimor dhe paraqiti Jack E. Lechner, mbikëqyrës i Varrezave Kombëtare Arlington, me një shenjë mirënjohjeje nga NATO, duke nderuar sakrificën e amerikanëve të rënë. Gjatë mëngjesit, me Grupin e Shkrimtarëve të Mbrojtjes, me bazë në Uashington, kryetari ndau pikëpamjet e tij mbi Afganistanin dhe të ardhmen e misionit të NATO-s, Resolute Support, situatën në Ukrainë, kërcënimin e ISIL, Task Forcën e Gatishmërisë së Lartë (VJTF) dhe Iniciativën e Mbrojtjes së Zgjuar midis temave të tjera. Gjithashtu, kryetari informoi gazetarët e mbledhur: "Nëse një komb apo një numër kombesh zgjedhin të sfidojnë integritetin e aleatëve, ata do të përballen me fuqinë e plotë të Aleancës më të fuqishme ushtarake në botë".

Jens Stoltenberg: NATO do të mbrojë çdo aleat

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, theksoi gjatë vizitës së tij në Poloni, më 6 tetor, se NATO do të mbrojë çdo aleat. "Detyra më e rëndësishme e NATO-s është mbrojtja e vendeve tona kundër sulmit. Ne do t'i mbrojmë të gjithë aleatët tanë", u shpreh Stoltenberg pas takimit me presidentin polak, Bronislaw Komorowski dhe kryeministren Ewa Kopacz në Varshavë.

Sfidat e sigurisë ndërkombëtare, duke përfshirë edhe veprimet agresive të Rusisë ndaj Ukrainës, progresin e zbatimit të vendimeve të marra në samitin e NATO-s në Uells si dhe përgatitjet për samitin e vitit 2016 në Poloni, ishin tema kryesore e bisedimeve. Sekretari i Përgjithshëm shprehu angazhimin e tij për zbatimin e plotë së vendimeve të samitit të Uellsit. Ai thekoi se hapat që po ndërmerren nga NATO për të përforcuar mbrojtjen kolektive janë në përputhje të plotë me angazhimet ndërkombëtare të NATO-s.

Z. Stoltenberg vlerësoi Poloninë për kontributin e saj të rëndësishëm në operacionet e Aleancës dhe angazhimin e saj në mbrojtjen e fortë: "Trupat polake shërbejnë në mënyrë shembullore në Afganistan dhe në Kosovë. Ju jeni një kontribuues kyç në sistemin tonë të mbrojtjes raketore. Së shpejti, Polonia do të shpenzojë 2% së prodhimit të saj së brendshëm bruto për mbrojtjen dhe ju po merrni vendimet e duhura për të investuar në pajisje të reja dhe aftësi".

Stoltenberg zhvilloi gjithashtu bisedime me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Mbrojtjes, Tomasz Siemoniak dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Grzegorz Schetyna, përpara nisjes në Bazën Ajrore Lask, për t'u takuar me personelin e Forcave Ajrore nga Polonia dhe vendet e tjera aleate. Vizita në Poloni ishte vizita e parë zyrtare e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, që nga marrja e detyrës në fillim të këtij muaji.

Stoltenberg falënderon pilotët aleatë dhe ekipet gjatë vizitës në bazën ajrore polake

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, falënderoi personelin e Forcave Ajrore nga Polonia dhe vendet e tjera aleate për shërbimin e tyre dhe mbrojtjen e hapësirës ajrore mbi pjesën lindore të Aleancës, gjatë një vizite në Bazën Ajrore Lask, më 6 tetor, në Poloninë Qendrore. "Ju po bëni një punë shumë të rëndësishme. Ju vini nga shumë vende të Aleancës, por ju dërgoni një mesazh të qartë: NATO është këtu. NATO është këtu për t'ju mbrojtur. NATO është këtu për të mbrojtur të gjithë aleatët", u shpreh Stoltenberg.

Në bazën ajrore, Sekretari i Përgjithshëm u takua me pilotët dhe ekipet nga e gjithë Aleanca. Ai pati mundësinë të shihte disa avionë luftarakë të përdorur në misionin e mbikëqyrjes ajrore të NATO-s në Baltik si dhe E-3A "Rojën" e Paralajmërimit Ajror të NATO-s dhe Avionin e Sistemit të Kontrollit (AWACS). Gjithashtu, Stoltenberg u përditësua nga komandantët ushtarakë mbi mbikëqyrjen ajrore të NATO-s dhe misionet AWACS.

Që nga fillimi i krizës së Ukrainës, NATO e ka forcuar në mënyrë të konsiderueshme mbrojtjen kolektive të Aleancës në kufijtë e saj lindorë. Në samitin e Uellsit, aleatët vendosën të mbajnë një prani të vazhdueshme ajrore, tokësore dhe detare si dhe aktivitet ushtarak në pjesën lindore të Aleancës, në bazë të një rotacioni. Kjo përfshin rritjen e patrullimit ajror mbi Baltik, fluturime AWACS mbi Poloni dhe Rumani si dhe rotacionin e forcave në të gjithë rajonin për stërvitjet.

Deklaratë për shtyp nga Jens Stoltenberg pas takimit të tij me kryeministren polake, Ewa Kopacz

"Kryeministre Ewa Kopacz, më lejoni së pari t'iu përgëzoj për pozicionin tuaj të ri dhe të nënvizoj se sa shumë pres që të punojmë së bashku me ju dhe qeverinë tuaj të re në përparimin e mbrojtjes tonë kolektive. Si një ish-kryeministër, e di se sa prioritete të ndryshme keni, por di gjithashtu se siguria dhe mbrojtja e Polonisë është një pjesë e rëndësishme e programit tuaj e po kështu është dhe anëtarësimi i Polonisë në NATO. Që nga dita që iu bashkua NATO-s, Polonia ka qenë një anëtare e angazhuar dhe aktive e Aleancës sonë. Unë jam mirënjohës për kontributin e konsiderueshëm të Polonisë në operacionet tona në Afganistan dhe Kosovë, kontributet tuaja në sistemin e mbrojtjes tonë raketore si dhe në mbrojtjen tonë kolektive. Unë e përgëzoj vendimin e Polonisë për të rritur me shpejtësi dhe në mënyrë të konsiderueshme shpenzimet e mbrojtjes, për ta sjellë në direktivat e NATO-s me 2% së prodhimit të brendshëm bruto si dhe vlerësoj përpjekjet që keni bërë në modernizimin e forcave tuaja. Ky është me të vërtetë një shembull i shkëlqyer. Një shembull të cilin do ta përdor kur të vizitoj aleatët e tjerë, sepse duhet të frymëzojë vendet e tjera që të bëjnë të njëjtën gjë si Polonia.

Kjo tregon se ne po marrim masa për t'i kthyer zotimet e marra në samitin e Uellsit në realitet. Në samit, ne morëm vendime të rëndësishme. Këto vendime do ta mbajnë NATO-n të fortë. Ato do të ruajnë stabilitetin në vendet tona fqinje duke punuar së bashku me partnerët si dhe do ta mbajnë lidhjen ndërmjet Europës dhe Amerikës së Veriut të fortë. Ne do të mbajmë një prani të vazhdueshme në pjesën lindore të Aleancës, do të vendosim një forcë në mënyrë që trupat tanë të jenë të gatshëm për t'u marrë me çdo kërcënim e do të sigurohemi që Plani i Gatishmërisë së Veprimit të zbatohet plotësisht. Ne po përballemi me një peizazh sigurie që po ndryshon në mënyrë dramatike në Lindje dhe në Jug. Këto sfida tregojnë se përse kemi nevojë për NATO-n. Aleanca mbetet themeli i sigurisë tonë. Detyra më e rëndësishme e NATO-s është mbrojtja e vendeve tona kundër sulmeve. Ne do të mbrojmë të gjithë aleatët tanë! Pra, kryeministre, Polonia qëndron e fortë brenda NATO-s dhe NATO qëndron e fortë me Poloninë. Faleminderit për pritjen që më bëtë në këtë periudhë vendimtare për Aleancën".

Deklaratë për shtyp nga Jens Stoltenberg pas takimit të tij me presidentin e Polonisë, Bronislaw Komorowski

"Z. president, është një kënaqësi që vizitoj Poloninë. Ky është vendi i parë që vizitoj si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Kjo është një njohje e rolit të fortë të Polonisë në Aleancën tonë dhe një shenjë e solidaritet të fortë të NATO-s në këto kohë të turbullta. NATO mbron çdo aleat. Në samitin e Uellsit, morën vendime të rëndësishme dhe të gjitha janë në përputhje me angazhimet tona ndërkombëtare. Polonia po kontribuon në mbrojtjen tonë kolektive me avionë, anije dhe trupa e ju po punoni me Gjermaninë dhe Danimarkën për të shtuar Selitë e Trupave Shumëkombëshe Verilindorë në Szczecin. Këto seli janë konfirmimi i mëtejshëm që NATO është në Poloni dhe me Poloninë. Gjithashtu, kjo tregon rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si dhe ndryshimin që mund të bëjë ky bashkëpunim në sigurinë e çdo vendi. Polonia është e angazhuar në mbrojtjen e fortë. Ju falënderoj për këtë dhe për udhëheqjen personale që keni treguar në mbrojtjen e Polonisë dhe forcimin e mbrojtjes kolektive së Aleancës tonë. Z. president, ju keni qenë një forcë lëvizëse për mbrojtjen e fortë të vendit tuaj dhe një promotor i fuqishëm i solidaritet të aleatëve dhe do të doja t'iu falënderoja personalisht që u ofruat për të pritur samitin tonë të ardhshëm të NATO-s, në vitin 2016. Kontributi i Polonisë në sigurinë e NATO-s është me rëndësi jetike dhe kontributi i NATO-s për sigurinë e Polonisë është dhe do të mbetet i fortë".

Alba Musaraj, burimi: NATO.int

Partnerët e koalicionit dhe përgjegjësitë në luftën kundër ISIS

MIMOZA GOLIKJA

Koalicioni i udhëhequr nga SHBA, ka rritur sulmet ajrore rreth qytetit kufitar sirian Kobane, këtë javë, menjëherë pasi Turqia bëri thirrje për ndihmë. Sulmet, që pasuan kërkesën e Turqisë janë vazhdimi i përpjekjeve të intensifikuara të SHBA për të parandaluar qytetin me shumicë kurde, të bjerë në duart e ISIS. Turqia nga ana e saj kishte rreshtuar tanket dhe trupat në kuadrin e luftëtarëve sirianë kurdë për të mbrojtur Kobane, por nuk ndërhyn për shkak të një lëmshi të arsyeve në marrëdhëniet e komplikuara me kurdët dhe dyshimet e saj në lidhje me qëllimet e koalicionit ndërkombëtar për të luftuar ekstremistët. Turqia këmbënguli, megjithatë, se ajo nuk do, që qyteti të bjerë dhe sipas burimeve një zyrtar i lartë tha se Ankaraja i kërkoi Shteteve të Bashkuara për të përshkallëzuar sulmet. "Turqia nuk do të jetë e kënaqur me rënien e Kobane në duart e organizatave terroriste", citojnë burimet deklaratën e zyrtarit të lartë, "qeveria jonë dhe institucionet e lidhur me të, kanë theksuar nevojën për të intensifikuar bombardimet ajrore në një mënyrë më aktive dhe efektive nëpërmjet kontakteve me zyrtarë amerikanë". Kurse nga ana e tij Departamenti i Shtetit nuk pranoi të komentojë mbi diskutimet, duke thënë vetëm se sekretari i Shtetit John Kerry foli në telefon dy herë me kryeministrin turk Ahmet Davutoglu dhe se bisedat ishin "gjerësisht për sfidat që ne kemi me ISIS me të cilat përballet gjithashtu dhe Kobane". Turqia është kritikuar gjerësisht për mosveprimin e saj të perceptuar. Komanda Qendrore amerikane në fillim të javës raportoi pesë sulme rreth Kobane, duke e dyfishuar numrin e kryer që nga fillimi i ofensivës. Sulmet ajrore erdhën në kohën kur ISIS ndërmori betejën në qendër të qytetit, e cila në fillim u shfaq si e suksesshme, por që u detyrua të sprapset dhe avancimi i luftëtarëve e humbi vrullin. Kobane ka vlerë të vogël strategjike, por nga ana tjetër cilësohet si një kalim kyç në Turqi dhe ISIS tashmë kontrollon disa qytete përgjatë kufirit turk. Por sulmi militant përkoi me zgjerimin e fushatës së ajrit e udhëhequr nga SHBA nga Iraku në Siri muajin e kaluar, duke vënë në qendër të vëmendjes përparime të ISIS në Siri dhe mungesës së Turqisë në koalicionin e formuar për të luftuar grupin. Pas paralajmërimit se Kobane ishte "gati të binte" dhe paralajmërimit për një "dush të afërt gjaku në qoftë se ata nuk ishin të përforcuar", presidenti turk Erdogan dha kushtet e vendit të tij për t'u bashkuar me koalicionin, citojnë burimet. "Ne kemi kërkuar për tre gjëra, një, për të krijuar një zonë ndalim-fluturimi, dy, për të deklaruar një paralele të sigurt të zonës në rajon dhe tre, për të trajnuar dhe pajisur opozitën e moderuar në Siri dhe Irak". "Unë i them Perëndimit, se rënia e bombave nga ajri nuk do të sigurojë zgjidhje", i tha Erdogan një numri sirianësh në qytetin jugor turk Gaziantep, popullsia e të cilit është rritur për shkak të fluksit të më shumë se 1.5 milion refugjatë në vend. Më shumë se 160.000 vetë kanë ardhur që kur filloi beteja për Kobane. Mirëpo, duke nënvizuar këtu pasojat e brendshme të mosveprimit të Turqisë, nga ana tjetër sipas burimeve, kurdët kanë organizuar protesta në të gjithë vendin dhe në disa qytete evropiane, duke kërkuar masa më të forta për të mbrojtur Kobane.

Zgjerimi i fushatës ajrore nga Iraku në Siri, mos veprimi turk

Në fakt, duket se fuqitë perëndimore po kërkojnë dhe po presin që Ankaraja të marrë përgjegjësinë për rajonin për zhdukjen e kërcënimit të menjëhershëm të shtetit islam me çfarëdo burimi të nevojshëm, në vend të ndjekjes së një strategjie në dukje e pamatur për përmbysjen e qeverisë siriane. Sjellja e Turqisë mund të jetë "hutuese dhe frustuese" për liderët perëndimorë, por kombinim i heshtjes në veprim dhe guximi në retorikë, për analistët, është se qeveria moderne turke po kërkon në Irak dhe Siri në njëfarë mënyre zgjerimin e sferës së ndikimit turk në tokat fqinje myslimane, "antidot për të dobësuar shtetet e Irakut dhe Sirisë". Edhe në qoftë se Turqia nuk ka më kontroll të drejtpërdrejtë mbi këto toka, ajo shpreson që të paktën në mënyrë indirekte të rivendosë vullnetin e saj me anë të partnerëve të zgjedhur, një grup i forcave të moderuara islamike në Siri ose në Irakun e veriut, një kombinim i Turkmenistanit dhe fraksioneve sunnite, së bashku me një fraksion kurd, të tillë si Partisë Demokratike të presidentit të Kurdistanit, Qeverisë Rajonale të Kurdistanit, Masud Barzani. Shtetet e Bashkuara aktualisht janë të përqendruara në shtetin islam dhe Turqia sipas disa analistëve, po kërkon këtë disa vite më parë aq më tepër me gjendjen e krijuar. Prandaj kjo është arsyeja edhe pse Turqia ka vendosur kushte për përfshirjen e saj në luftën kundër ISIS. Ajo po përpiqet për të bindur Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e saj arabë sunni të koalicionit se do të jetë e pashmangshme fuqia e administrimit në këtë rajon. Prandaj, sipas Ankarasë, të gjithë lojtarët duhet të jenë në përputhje me prioritetet e saj. Megjithatë, analistët thonë se vizioni turk i rajonit thjesht nuk përshtatet me realitetin aktual. Kurdët, në veçanti, do të vazhdojnë të jenë "thembra e Akilit" e politikave turke. Në qytetin Kobani në kufirin e Turqisë, Ankaraja po ballafaqohet me mundësinë e tërheqjes në një luftë në terren me një forcë të mirë-pajisur kryengritëse. Për më tepër, kur Turqia do të luftojë në anën e njëjtë edhe me separatistët kurdë, duke përfshirë anëtarët e Partisë të Turqisë të Punëtorëve të Kurdistanit, por Turqia duket se përballet me të njëjtën dilemë në Irak, ku ajo padashur mund të mbështesë separatistët kurdë në luftën e saj kundër ISIS. Madje kështu në këtë gjendje kritike, Turqia nuk mund të ndjehet mirë me idenë se Kirkuku është në duart e kurdëve të Irakut, qytetit naftëmbajtës të energjisë. Por Turqia ka konkurrencë dhe kjo, është një fushë beteje që Turqia e di mirë. Loja e gjatë dhe e përpunuar nga "të mbajtur larg", për të parandaluar kurdët të konsolidojnë kontrollin mbi territorin e pasur me naftë në zonën kufitare kurde-arabe, "nxjerr në funksion të plotë konkurrencën mes Turqisë dhe Iranit". Mirëpo Turqisë për të konkurruar në mënyrë efektive në këtë hapësirë, do t'i duhet të pajtohet me realitetin, historinë, kurdët brenda kufijve të saj dhe pengesat e huaja. E ndërsa Erdogan tha se "Turqia nuk do të përfshihej më thellë në konflikt me

shtetin islam nëse Shtetet e Bashkuara nuk bien dakord të japin mbështetje më të madhe për rebelët në përpjekje për të mundur presidentin sirian, Bashar al-Assad". Kjo nga ana tjetër ka thelluar tensionet me presidentin Obama, i cili do të donte që Turqia të merrte veprim të forta kundër ISIS dhe të linte luftën kundër al Assad. Administrata Obama është "e frustruar" nga ajo që konsideron si arsyetime të Turqisë për të mos bërë më shumë ushtarakisht. Madje zyrtarët kanë vënë re, për shembull, lidhur me pretendimet e Erdogan se koalicioni i udhëhequr nga SHBA, me "rrotullimin e tij të rëndë të fluturimeve dhe sulmeve ajrore, ka imponuar në mënyrë efektive një zonë ndalim-fluturimi mbi Sirinë veriore tashmë" dhe se Turqia "zvarritet për të vepruar në parandalimin e një masakre më pak se një milje nga kufiri i saj," tha një zyrtar i lartë i administratës. Sekretari i Shtetit John Kerry ka pasur telefonata të shumta në 72 orët e fundit me kryeministrit turk, Ahmet Davutoglu, dhe ministër i jashtëm, Mevlut Kavusoglu, të përpiqen për të zgjidhur krizën e kufirit, thanë zyrtarët amerikanë. Për presidentin Obama, një ndarje me Turqinë do të rrezikojë përpjekjet e tij për të mbajtur së bashku një koalicion të vendeve sunite myslimane për të luftuar Isis. E ndërsa Turqia, ka vënë argumentin e largimit të al Assad më përpara për të mposhtur sunnitët radikale të shtetit islam, Shtëpia e Bardhë ka argumentuar fuqishëm se kërcënimi i menjëhershëm janë militantët. Prandaj nëse Turqia vazhdon të mbetet në këtë pretendim "koalicioni rrezikon të ketë thyerje". Turqia është jo vetëm aleat i NATO-s, por ndërkohë rruga kryesore e tranzitit për të huajt që kërkojnë të bashkohen me ISIS. Zyrtarët amerikanë, e dinë se lufta mbi ISIS nuk mund të shtyhet pa trupat tokësore, të nxjerra nga radhët e opozitës siriane. Por deri sa këto trupa të trajnohen, pajisen dhe të vihen në fushë "do të dojë pak kohë" thonë zyrtarët dhe Turqia, "mund të luajë një rol jetik, për të mbrojtur qendrat e popullsisë dhe për të mbështetur ofensiva në terren në Irak, ku janë partnerët, si luftëtarët kurdë peshmerga dhe ushtria irakiane", theksojnë burimet. Prandaj situata është delikate ndërkohë kur marrëdhëniet midis kurdëve dhe turqve ishin qetësuar dhe ajo që duhet të vlerësohet për momentin është "shkatërrimi i ISIS si streha e sigurt e dhunës, si degraduese e infrastrukturës, si e kontrollit kritik dhe komandës mbi rafineritë dhe zonat e naftës. Komanda Qendrore e ushtrisë konfirmoi të martën se avioni i koalicionit kishte kryer pesë sulmet ajrore kundër pozicioneve shtetërore islame në zonën Kobani në dy ditët e fundit. Ndërkohë edhe Staffan de Mistura, i dërguari i Kombeve të Bashkuara për Sirinë, ka lëshuar një thirrje t të fortë për të marrë "masa konkrete" për të parandaluar Kobanin të bjerë në kontrollin e ISIS. "Bota, të gjithë ne, do të ndjehemi thellësisht keq nëse ISIS është në gjendje të marrë një qytet i cili ka mbrojtur veten me guxim, por tashmë nuk është në gjendje për ta bërë këtë. Ne duhet të veprojmë tani", tha ai.

Po çfarë është beteja për qytetin kurd Kobane?

Nxitja e tensioneve brenda Turqisë, kur mijëra protestues dolën në rrugë për të shprehur zemërimin dhe zhgënjimin në lidhje me mosveprimin e qeverisë së Ankarasë, ilustrojnë ndikimin e brendshëm dhe rajonal të thellimit të krizës. Raportet thanë se demonstratat u bënë të dhunshme dhe policia turke përdori gaz lotsjellës, raportet e medias turke dhanë deri në 14 persona të vrarë në qytetet lindore dhe më shumë se dhjetëra të plagosur. Parlamenti turk javën e kaluar ka autorizuar qeverinë për të ndërmarrë veprime ushtarake kundër ISIS, por Turqia nuk ka njoftuar planet për çdo operacion, në pritje të një angazhimit nga perëndimi për të lëvizur me vendosmëri kundër presidentit sirian, Bashar al-Assad si dhe xhihadistëve. ISIS tani kontrollon pjesë të mëdha të Sirisë dhe Irakut dhe ka rritur shumë ofensivën e saj në ditët e fundit pavarësisht se janë në shënjestër nga sulmet ajrore të udhëhequra nga SHBA. Në anën turke të kufirit, gazetarët dëgjuan zhurmën e avionëve luftarakë dhe panë shtëllunga e mëdha të tymit në perëndim të Kobanit. BBC raportoi tetë sulme në total dhe vendi anëtar i NATO-s, Turqia tashmë është bërë një partner i rëndësishëm i vijës së parë në koalicionin ndërkombëtar kundër shtetit islam. Javën e kaluar, ligjvënësit turq dhanë miratimin për të vendosur trupa në Sirinë dhe Irakun fqinj për të luftuar militantët. Tanket dhe trupat turke kanë përforcuar vijën kufitare, të cilat janë nën mbikëqyrjen e betejave dhe sulmeve ajrore rreth qytetit kufitar të Kobane, kur luftëtarë kurdë sirianë u përpoqën për të mbajtur jashtë ofensivën e ashpër të ISIS. Turqia është një përkrahës i vendosur i grupeve rebele siriane, dhe ka lidhur bashkëpunimin e saj në luftën kundër ISIS me përpjekje të shtuara për të rrëzuar al Assad. Administrata Obama gjithashtu ka propozuar zgjerimin e ndihmës për "rebelët e moderuar sirianë si prokurë të forcave kundër ISIS". Më vete, forcat ushtarake amerikane përdorën avionë për të pilotuar nga distanca dhe helikopterë, ku kryen tri sulme në Irak. Vendosja e helikopterëve të sulmit të SHBA në fushën e betejës në Irak, tregon se trupat irakiane kanë nevojë për mbështetje më të afërt ajrore në luftën kundër militantëve islamikë të ISIS. Avionët janë të njohur për saktësinë e tyre të zjarrit të raketave nga disa kilometra larg dhe mund të ndihmojnë për të goditur objektiva të lëvizshme të tilla si kamionët e armatosura ose trupa tokësore, sipas specialistëve, por për shkak se helikopterët fluturojnë në lartësi të ulëta, ata janë edhe më të prekshëm për raketat, granata dhe armë të tjera. Veprimet e ISIS në qytetin kurd Kobane është parë nga trupat turke, monitoruar nga spektatorët dhe transmetuar drejtpërdrejt në të gjithë botën nga kanalet e lajmeve që kur militantët nisën ofensivën e tyre dy javë më parë dhe qyteti është aq afër me Turqinë sa minaret e xhamive të saj në mënyrë të qartë mund të shihet nga ana turke e kufirit. Observatori sirian për të Drejtat e Njeriut në Londër raporton se të paktën 400 vetë janë vrarë gjatë tre javëve të luftimeve midis ISIS dhe luftëtarëve kurdë dhe rreth qytetit sirian kufitar të Kobani dhe se kishte dokumentuar 412 të vdekur nga burime në terren, por shifra e vërtetë mund të jetë edhe më e madhe.

Kapja e Kobane do t'i jepte kontrollin ISIS në një shtrirje më të gjatë të kufirit turko-sirian dhe linja të hapura, të mundshme, të reja, të kontrabandës për luftëtarë dhe furnizime. Nëse ISIS kap Kobane ai do të kontrollojë tre kalime kufitare me Turqinë dhe kontrabanda do të bëhet shumë më e lehtë. Kobane kishte një popullsi prej rreth 300.000 para sulmeve të Isil. Shumica janë kurdët dhe kanë përkatësitë politike me Partinë e Punëtorëve të Kurdistanit. Kurdët deklaruan vetëqeverisje në janar 2014 në zonat të cilat tani po sulmohen nga Isil. Kobane është bërë një fushëbetejë vendimtare në luftën ndërkombëtare kundër luftëtarëve Isil dhe beteja ka detyruar rreth 186.000 civilë të largoheshin për në Turqi. Prandaj kur Parlamenti turk në Ankara javën e kaluar i autorizoi qeverinë për t'u bashkuar me fushatën e udhëhequr nga SHBA kundër Isil, por që nuk ka plane për veprime ushtarake të shpallura deri më tani, vendi e ka gjetur veten në një "pozicion tepër të vështirë". Për dekada të tëra, konflikt i përgjakshëm ka shpërthyen midis Turqisë dhe pakicës kurde, kërkesat e të cilëve gjatë viteve kanë përfshirë vetë-rregull, të drejtat themelore dhe liritë më të mëdha. Në vitin 1984, Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK), të cilat janë cilësuar si "një organizatë terroriste", njoftuan kryengritjen kurde kundër shtetit turk. Që atëherë, më shumë se 40.000 njerëz janë vrarë në Turqi si pasojë e konfliktit dhe ndërkohë Turqia, përballet me rritje të kritikave se ajo "ka kthyer një sy qorr ndaj luftëtarëve ekstremistë që shpesh kalojnë kufijtë e pambrojtur të Turqisë me Sirinë dhe rekrutojnë luftëtarë të rinj në qytete turke". Shumë luftëtarë të huaj që kërkojnë të bashkohen me shtetin islamik fluturojnë në Stamboll, por në veçanti, Turqia është seriozisht e shqetësuar se Njësitë e Mbrojtjes Popullore, forca siriane kurde e luftimit, që tani kontrollon Kobani, mund të fitojë më shumë pushtet. Njësitë e Mbrojtjes Popullore janë lidhur me PKK, e Turqia e konsideron një organizatë terroriste. Javën e kaluar, kur Parlamenti i Turqisë votoi për t'i dhënë qeverisë autoritetin për të ndërmarrë veprime ushtarake në Irak dhe Siri, votimi gjithashtu i dha qeverisë aftësinë për të lejuar vendet e huaja të përdorin Turqinë si një bazë për sulme kundër shtetit islam. Por ndërsa vota ka marrë shumë vëmendje, analistët thonë se Turqia ka votuar për të teorikisht. Por nga ana tjetër Turqia, kërkon të ruajë pozitat e saj edhe kur nënvizohet se ajo "ka bërë të qartë se nuk kërkon të pushtojë Sirinë" në të vërtetë, ka shumë arsye sipas analistëve për këtë, sepse "kapaciteti ushtarak, pengesa ligjore, ndjeshmëria politike e brendshme, mundësia e hakmarrjes siriane dhe detyrimet si vend anëtar i NATO-s" janë disa prej tyre.

Të qenët Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s më 11 Shtator

Të qenët Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s është gjithmonë një detyrë e tejmbushur me sfida dhe të papritura. Por, më 11 Shtator 2001, Lordi Robertson përjetoi një ndër përvojat më të jashtëzakonshme nga të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm të NATO-s. Këtu, ai rrëfen si ia doli mbanë asaj dite. Në Shtabin e NATO-s në Bruksel, ajo ishte vetëm një e martë e zakonshme. Një ditë që do të linte gjurmë të pashlyeshme. Një ditë që do të ndryshonte rrënjësisht botën dhe NATO-n. Megjithatë, në fillim të ditës, ishte vënë re një imtësi fare e thjeshtë. Në postë ishte një letër nga Beogradi ku më thuhej se akuzat dhe provat e mia për fajësinë e Millosheviçit, në një gjyq të paligjshëm për krime lufte gjatë konfliktit në Kosovë, ishin rrëzuar zyrtarisht. Dënimi me 25 vjet burg, i paraqitur nga ana ime, ishte shfuqizuar. Kjo ishte një ngjarje që, në çdo ditë tjetër, do të përbënte një objekt për përhapje lajmi. Por jo atë të martë. Çdo të martë pas drekës, ambasadorët e NATO-s takohen me Sekretarin e Përgjithshëm në një diskutim jozyrtar jashtë protokollit mbi çështjet e rendit të ditës të mbledhjes së nesërme të Këshillit të NATO-s. Ai ishte i pandryshueshëm. Pa ndërprerje, pa njoftime paraprake, pa kufizime.

”Kështu që, ndërprerja e shkaktuar prej njërit nga rojat e mia vetjake me sjelljen e njoftimit të ndihmësit tim personal, ishte e pashembullt. Një aeroplan kishte goditur një prej kullave binjake në Nju Jork. Ishte diçka befasues. Por hamendësimi ishte për një aksident.

Ndërprerja e dytë ishte tronditëse. Një aeroplan i dytë, dhe ky ishte një incident i madh.

Pjatat u braktisën, bisedat përfunduan, makinat u thirrën dhe me shpejtësi të madhe u rikthyen në selinë e NATO-s. Në makinën time të koracuar unë dëgjova Shërbimin Botëror të BBC-së me ankth dhe shqetësim në rritje.”

Në zyrën time, i rrethuar me personel të lartë diplomatik dhe ushtarak, ne pamë me pjesën tjetër të botës pamjet tronditëse nga Nju Jorku. Atëherë u vetëdijesova se nuk ishim thjesht shikues të tronditur thellë – ne ishim në një shtab ushtarak. Jo vetëm aq, ne ishim pikërisht nën rrugëkalimin e fluturimit të Zaventemit, aeroportit të Brukselit. Ndërkohë që ne bisedonim, aeroplanët uturinin mbi kokat tona. Kur pamjet e kullave që shembeshin kishin magnetizuar planetin, dhashë urdhrin për shpërnguljen e pothuajse gjithë personelit të domosdoshëm dhe për kontrollin e ngutshëm me anën e “Eurokontrollit” (Trafikut Ajror) të moskthimit sërishmi të aeroplanëve të larguar. Ambasadorët e NATO-s u thirrën

në një mbledhje të menjëhershme. Ambasadori amerikan Nik Bërns më informonte në mënyrë të vijueshme mbi zhvillimet e tjera në Uashington. Goditja mbi Pentagon, që unë e kisha vizituar jo shumë kohë më parë, ishte veçanërisht me ndikim mjaft të ndjeshëm për NATO-n. Sulmi i dështuar në Kapitol ishte gjithashtu shushatës. Mbledhja e ambasadorëve ishte e zymtë dhe e rëndë. Në atë moment, ne nuk kishim dijeni të plotë për shkakun apo kombësinë e kriminelëve të kësaj mizorie – nuk kishte kaluar shumë kohë qëkurse bombashpërthyesi në Oklahomë kishte kryer sulmin e tij të vetëpërgatitur. Por kjo sigurisht që dukej si terrorizëm nga jashtë dhe në përmasa të mëdha.

Ne e kuptonim që diçka thelbësore kishte ndodhur dhe se për botën ishte hapur një kapitull i ri. Për ne rreth asaj tryeze, në vendndodhjen e aleancës mbrojtëse më të suksesshme në botë, simpatia dhe solidariteti i sinqertë i shprehur ndaj njerëzve të SHBA-ve u përplotësua me mendimet lidhur me atë se çfarë do të nënkuptonte e gjithë kjo për organizatën tonë dhe për sigurinë botërore më gjerë. Gjatë kohës së mbledhjes, zyrtarët e mi të drejtuar nga Ndihmëssekretari i Përgjithshëm, Edgar Bakli (Buckley) dhe Drejtori i Zyrës Private, Xhon Dei (John Day), ishin duke punuar mbi atë çka duhej të përgatisnim ngutësisht përballë kësaj goditjeje. Një nga mundësitë zgjedhëse e vlerësuar tejet e rëndësishme ishte nëse kjo goditje ndaj Shteteve të Bashkuara nënkuptonte kërkesën për ndihmë sipas Nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut – klauzola e vetëmbrojtjes. Një sulm mbi një shtet të vlerësohej si një sulm mbi të gjitha 19 vendet e atëhershme të NATO-s. Puna për atë dhe për një përgjigje më të gjerë të NATO-s duhej të kryhej gjatë natës. Mandej, në mëngjes herët, do të bashkëbisedohej me Sekretarin e Shtetit të SHBA-ve, Kolin Pauell dhe me Këshilltaren për Sigurinë Kombëtare, Kondoliza Rajs. Unë këmbëngula se Neni 5 ishte i zbatueshëm dhe ishte akti i fundit i solidaritetit me popullin e SHBA-ve. Çfarë kuptimi do të kishte klauzola e vetëmbrojtjes në qoftë se nuk do të ishte e vlefshme në këtë moment dramatik të agresionit? Dyshime ishin shfaqur – veçanërisht nëse edhe vetëm një prej 19 vendeve të NATO-s të mos pranonte. “Këtu unë po thyeja rregullin tim më të fshehtë “Solana”. Paraardhësi im, Javier Solana, më kishte dhënë një këshillë të urtë para se të vija në Bruksel. “Xhorxh, mos shko asnjëherë në Këshill me një propozim nëse nuk e di që përgjigjja do të jetë thuajse “po” ose në rastin më të keq “ndoshta” – më pat shpjeguar ai. “Nëse ju mposhteni në Këshill, atëherë jo vetëm që humbet autoriteti juaj, por edhe ai i NATO-s”.

Ajo ishte këshillë e mire; unë nuk e mbajta parasysh.”

Ne patëm një takim, i pari i mbajtur ndonjëherë nga një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s në Këshillin e Ministrave të Jashtëm të BE-së. Askush nuk pyeti rreth Nenit 5 (kjo, për shkak të shqyrtimit paraprakisht të çështjes me Ministrin e Jashtëm të Belgjikës, Lui Mishel, të Presidencës së BE-së). Mandej unë paraqita Projektdeklaratën ku i drejtoheshim Nenit 5. Ishte hera e parë në 50 vitet e NATO-s që ai po vihej në veprim. Mandej pasuan pesë orë e gjysmë vlerësime në 19 kryeqytete. Unë zhvilloja biseda telefonike të rënduara, tepër acaruese me kryeministra, ministra të jashtëm dhe, në një rast, përmes telefonit celular të ministrit të jashtëm, me gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e kabinetit. Rreth orës 9:20 të darkës përgjigjja ishte gati. Mbështetje e njëzëshme. Unë isha i rraskapitur, por tepër i lehtësuar. Unë lexova deklaratën e miratuar në një konferencë shtypi të tejmbushur me pjesëmarrës dhe vetëm pasi e kisha përfunduar së lexuari atë, e kuptova domethënien e thellë të fjalëve historike që kisha shprehur. Si në Europë edhe në SHBA-të, ndikimi ishte tejet i madh. Madje nuk do të mund të mos ishte vënë re edhe në shpellat e maleve Tora Bora, ku ishte shpikur kriminaliteti çnjerëzor i mizorisë së një ditë të mëparshme.

”Në rrethana shumë të ndryshme prej atyre të parashikuara nga autorët e Nenit 5 në vitin 1949, Aleanca e fuqishme kishte qëndruar në gatishmëri për të vepruar në mbështetje të një aleati nën goditje. Bota atë ditë kishte ndryshuar, dhe shndërrimi i NATO-s në botën e pas 11 Shtatorit kishte filluar.”

Burimi: Revista e NATO-s

Kontributi i ushtarakëve shqiptarë në paqeruajtjen botërore

Sot, bota vazhdon të trashëgojë grindje, përplasje, luftëra nga më të përgjakshmet. Paqebërja dhe shuarja e konflikteve është një plagë ende e pambyllur edhe pas shumë ndërhyrjeve të OKB-së dhe organizatave më të njohura ndërkombëtare. Nxjerrja në pah e shkaqeve, skenave dhe prapaskenave që "ushqejnë'' konfliktet, ka bërë që roli i forcavet ë armatosura kudo në botë të ridimensionohet dhe të fokusohet edhe në "paqeruajtje". Paqebërja dhe paqeruajtja janë "profesioni" më i ri i ushtarakut shqiptar. Shqiptarët e "prekën" me vonesë paqeruajtjen dhe po me vonesë e mësuan atë dhe rolin e saj. Shqiptarët dhe ekipi që i drejtonte për gjysëm shekulli gjatë shekullit XX jo rrallë u "ikte treni" i pjesëmarrjes në ngjarje madhore të kohës, dhe po kështu edhe mundësia e ofrimit të kontributeve ndërkombëtare si "paqeruajtja" e "paqebërja". Teknikat e "Paqeruajtjes" u mësuan dhe u trajtuan me vonesë në raport me shtetet e tjera, ku "Paqeruajtja" shërbente si një mjet për trajtimin e konflikteve ndërshtetërore dhe luftërave civile. Në fakt FA shqiptare sikurse ato të ushtrive më të përparuara mbeten shtylla themelore e operacioneve paqeruajtëse kudo në planet. Fytyra e paqeruajtësve përfshin në radhë të parë ushtarakët, administratorët, ekonomistët, oficerët e policisë, ekspertët ligjorë, vëzhguesit e zgjedhjeve, specialistët e çështjeve civile dhe të qeverisjes, punëtorët humanitarë të komunikimit dhe ekspertët e informimit publik. Shqiptarët janë të njohur edhe me problematikën reformuese të paqeruajtjes siç është "Doktrina Capstone" (2008), që në fakt është strategji e reformës së Departamentit të Operacioneve Paqeruajtëse (DPKO), që lidhet me sigurinë kolektive për shekullin e ri, e cila krijon strategji gjithëpërfshirëse, duke përfshirë edhe fushën e sjelljes dhe disiplinës. "Misionarë të paqes", pjesëtarë të FASH, zhvillojnëmë tej traditën e ushtarakëve shqiptarë si paqeruajtës".

Ka pothuaj dy dekada që misionarët e paqes nga FASH mbrojnë me kurajë e profesionalizëm jetët e pafajshme të kërcënuara nga terrorizmi, këtij armiku nga më të egrit e njerëzimit.

Paqeruajtësit janë luftëtarë antiterroristë në mbrojtje të lirisë së kombeve dhe aspiratave të të gjithë kombeve, në një front me trupat paqeruajtëse botërore. Deri në marsin e vitit 1992 Shqipëria ishte vend i izoluar; ndërsa pas këtij viti, kur triumfoi demokracia, Shqipëria u ftua të bëhej anëtare e Programit të NATO-s, Partneriteti për Paqe. Për herë të parë në shtator 1996, Shqipëria dërgoi 33 trupa për të shtuar Forcën e Zbatimit të Paqes "Peace Implementation Force" (IFOR)19, ku trainimin e parë si paqeruajtës e morën në Gjermani. Fillimisht u vendosën në Kroaci dhe më vonë në kampin frankogjerman në Rajlovac. Pas vitit 1996 kontingjentet paqeruajtëse erdhën duke u shtuar dhe që shërbyen jo vetëm në Bosnjë, por edhe në Irak, Afganistan, Chad, Gjeorgji etj. Misioni paqeruajtës shqiptar u larguan pas përfundimit të mandatit paqeruajtës të Kombeve të Bashkuara nga Iraku në dhjetor 2008.

Angazhimi i Forcave tëArmatosura shqiptare në misionin SFOR të drejtuar nga NATO, ka filluar në 09.09.1996 me dërgimin e kontingjentit të parë Paqeruajtës, të bazuar në Ligjin Nr. 8139, datë 05.09.1996. Angazhimi në misionin "Althea" të drejtuar nga Bashkimi Evropian, ka filluar në 02.12.2004. Forcat eArmatosura shqiptare u angazhuan nëmisionin ISAF nën drejtimin e NATO-s në gusht 2002, me dërgimin e Kontingjentit të Parë Paqeruajtës. Aktualisht, forcat ushtarake shqiptare, që përfaqësojnë imazhin e Shqipërisë dhe përcjellin mesazhe të paqes kryejnë operacione të përbashkëta në Kandahar, Herat, Kabul, Komandën Rajonale të Veriut, krah për krah me Kontingjentet e SHBA-së, Italisë, Gjermanisë, Turqisë e Hungarisë etj. Në korrik të vitit 2008, Forcat eArmatosura Shqiptare kanë angazhuar edhe një kontingjent në operacionin e Eufor Tchad-Rca, drejtuar nga Bashkimi Evropian në Çad të Afrikës. Deri tani në këtë mision kanë marrë pjesë 189 ushtarakë shqiptarë. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjen me Bashkimin Evropian, për dërgimin e trupave në Çad, si pjesë në misionet ushtarake të BE-së. Është fakt se një marrëveshje e veçantë është nënshkruar midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Francës, për mbështetjen e trupave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ushtarake të BE-së. Në Kandahar, forcat speciale shqiptare janë angazhuar për herë të parë në operacione luftimi krah për krah forcave speciale amerikane të brigadës 525. Forcat speciale shqiptare janë vlerësuar nga Komanda Rajonale e Jugut, për kurajon, guximin dhe profesionalizmin që tregojnë në kryerjen e detyrave në këtë zonë luftimi me rreziqe të shumta. Serioziteti dhe forca e paqeruajtësve shqiptarë erdhi në rritje, deri në arritjen e një forcë paqeruajtëse reale e të ndërveprueshme. Në gati dy dekada në të gjithë misionet në Bosnjë, Irak, Afganistan, në Çad, Gjeorgji etj., kanë qenë të konsiderueshme për kapacitetet shqiptare. Kështu nga muaji Shtator i vitit 1996 dhe deri në muajin shkurt 2013, janë përfshirë në misione paqeruajtëse gjithsej 6033 ushtarakë. Sigurisht që kontributi shqiptar është modest, por krahasuar me popullsinë, burimet, Forcat e Armatosura, buxhetet etj, shqiptarët janë bërë pjesë e kontributit botëror të paqeruajtjes. Faktikisht vitet e fundit, ritmi i veprimtarive ndërkombëtare në angazhimin e shteteve ka ardhur duke u rritur vazhdimisht. Aktualisht, Kombet e Bashkuara kanë të dislokuar 70 mijë trupa në 17 misione të ndryshme paqeruajtëse në botë. Bashkëpunimi dhe dialogu mes vendeve të Evropës Jug-Lindore zhvillohet sot me kontributin për siguri dhe stabilitet rajonal, si dheme nxitjen emarrëdhënieve të fqinjësisë. Kështumë 26 Shtator 1998, Ministrat e Mbrojtjes së shtatë vendeve pjesëmarrëse, firmosën në Shkup, "Marrëveshjen për një Forcë Shumëkombëshe për Paqe të Evropës Jug- Lindore". Sllovenia dhe Shtetet e Bashkuara, si vende vëzhguese, shprehën mbështetjen e tyre dhe angazhimin për të kontribuar në këtë iniciativë. Kjo iniciativë konsiston në përputhshmëri të plotë me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, një forcë transparente dhe e hapur për NATO-n e vendet e Partneritetit për Paqe në rajon, që synon bashkëpunimin rajonal në kuadër të OKB-së, NATO-s, OSBE-së, dhe BE-së. Paqeruajtja si, "parandalim, kufizim, moderim dhe ndërprerje e armiqësive brenda shteteve" gjatë shtatë dekadave ka bërë hapa përpara por nuk e ka përmbushur misionin. Një ridimensionimi politikave, diplomacive dhe praktikave të paqeruajtjes dhe paqebërjes si dhe ristrukturimi dhe riformatimi i institucioneve që prodhojnë siguri globale tëOKB-së është plotësisht i justifikuar. Kriza globale dhe kufizimi i ndërhyrjeve energjike që kërkojnë mjete të fuqishme financiare kanë detyruar Këshillin e Sigurimit të OKB-së që të jenë të matur e ndonjëherë edhe të kufizuar. Kontingjentet që mbushin radhët e paqeruajtësve e paqebërësve janë para së gjithash ushtarakë që përfaqësojnë 122 shtete të globit. Por, para se të jenë paqeruajtës, ata janë qenie njerëzore, me interesa e botë njerëzore të gjerë, me përvoja individuale, që në situata të caktuara krijojnë tension, çrregullim. Interesi i grupit nëmision është unitetime fuqi e aftësi fizike, gatishmëria për të reaguar më intensitet të lartë ndaj situatave. Debati shkencor në këtë fushë në mënyrë të argumentuar do të jetë i dobishëm për shoqërinë shqiptare sepse ashtu sikurse shprehet Anthony Gidens: "Sociologjia është shkencë që nënkupton metodat sistematike të studimit dhe vlerësimit të teorive nën dritën e fakteve dhe argumenteve logjike". Këto argument logjike duhet të "mblidhen" nga faktet e përvojave botërore por edhe nga përvoja e paqeruajtësve e paqebërësve shqiptarë që tashmë kanë një përvoj afërsisht 20 vjeçare. Në një kohë kur Shqipëria është prej pesë vitesh anëtare e NATO-s, Forcat e Armatosura synojnë përgatitje të një korpusi elitar ushtarakme numër të reduktuar, por më profesionist. Praktikisht zhvillimet strukturore ushtarake shqiptare përputhen me atë që thotë Samuel P. Hantington se, "Korpusi modern i oficerëve është një grupim profesional dhe oficeri është një individ profesionist". Ushtarakët shqiptarë janë gjithmonë të gatshëm sepse, "Në një botë që ndryshon, NATO qëndron gjithmonë e gatshme".

Marrë me shkutime: nga Revista Ushtarake, gusht 2014

Të bashkuar kundër ISIS, të ndarë në fushëbetejë

Ndarjet mund të dobësojnë koalicionin e udhëhequr nga SHBA-ja në Irak dhe Siri

Përmbledhje

Gjatë javëve të kaluara, koalicioni i udhëhequr nga SHBA-ja, duke kryer sulme ajrore kundër pozicioneve të Shtetit Islamik në Irak dhe Siri, është zgjeruar duke përfshirë disa anëtarë të rinj. Kjo ka rritur fuqinë e tij të përgjithshme ushtarake për të luftuar dhe për ta përhapur barrën në mënyrë më të barabartë. Parlamenti Britanik votoi më 26 shtator për t'u bashkuar me grupin dhe ka filluar sulmet ajrore mbi Irak. Gjithashtu, Danimarka dhe Belgjika vendosën të marrin pjesë në operacionet e drejtpërdrejta luftarake. Këta partnerë të rinj u bashkuan me dy kolegët europianë, Francën dhe Holandën si dhe Australinë. Në mënyrë të dukshme, këto gjashtë vende kanë zgjedhur të kufizojnë rolin e tyre luftarak në Irak. Kjo bie në kontrast me rolin e pesë partnerëve arabë së Shteteve të Bashkuara, Jordaninë, Arabinë Saudite, Bahreinin, Katarin si dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, të cilët kanë kryer sulme ajrore me Shtetet e Bashkuara në Siri, që me zgjerimin e operacioneve më 23 shtator.

Kjo ndarje e çuditshme e punës nuk do të veprojë në interes të efikasitetit, por është një objekt i realitetit të komplikuar të vënë përballë terrenit dhe arenës politike. Fushëbeteja kundër Shtetit Islamik ndahet gjoja ndërmjet shteteve sovrane të Irakut dhe Sirisë. Megjithatë, në realitet, ajo është një hapësirë e vetme mbi atë që është bërë një kufi imagjinar. Koalicioni i ndarë reflekton pikëpamjet divergjente të anëtarëve politikë në menaxhimin e situatave përkatëse të Irakut dhe Sirisë. Në fund të fundit, marrëveshja ndan artificialisht atë që duhet të trajtohet si një fushëbetejë e vetme dhe një armik i vetëm. Kjo dobëson koalicionin, ngatërron rezultatet e dëshiruara dhe shpesh kufizon operacionet për atë që do të qetësojë të gjithë anëtarët.

Analizë

Ndarja në dy pjesë e hapësirës së betejës të koalicionit ka çuar tashmë në ndryshime në zgjedhjen e synuar. Qëkur operacionet e kufizuara amerikane në Irak u zgjeruan në Siri, Shtetet e Bashkuara dhe anëtarët e koalicionit arab janë fokusuar në infrastrukturën kritike në Siri që mbështet operacionet e Shtetit Islamik në Siri dhe Irak. Kjo ka përfshirë qendrat e komandës, operacionet financiare, depot e furnizimit dhe më së fundi, rafineritë e naftës. Strategjia e koalicionit në Siri ka qenë për të degraduar aftësitë ushtarake të Shtetit Islamik me anë të shkatërrimit ose të ndërprerjes së aseteve kritike që e mbështesin atë.

Strategjia në Irak, megjithatë, ka qenë mjaft e ndryshme. Atje, fokusi i fushatave ajrore ka qenë përkrahja e operacioneve tokësore. Kjo është përkthyer në mbështetje të ngushtë ajrore për peshmergën kurde dhe forcat kombëtare të qeverisë ashtu si dhe sulmet që kanë për qëllim shkatërrimin e furnizimeve ushtarake, automjeteve dhe armëve të rënda së Shtetit Islamik të përdorura në operacionet kundër atyre forcave. Kjo divergjencë buron pjesërisht nga situata të ndryshme taktike në çdo vend: Në Irak, koalicioni po vepron në koordinim të drejtpërdrejtë me forcat lokale, ndërsa në Siri përpjekjet për të lehtësuar sulmet tokësore kundër Shtetit Islamik janë në fazat e hershme, vetëm me hapat e parë që janë ndërmarrë për të trajnuar rebelët sirianë kundër regjimit në Arabinë Saudite.

Këto realitete të ndryshme taktike janë vetëm një pjesë e tablosë. Dallimet kryesore mes këtyre operacioneve janë shpjeguar nga partnerët e domosdoshëm që veprojnë në Irak dhe në Siri. Partnerët arabë sunni së Shteteve të Bashkuara kanë një interes të marrin pjesë në operacionet kundër Shtetit Islamik në Siri. Degradimi i aftësive të Shtetit Islamik largon presionin e rebelëve të anti-regjimit duke luftuar Damaskun dhe forcat e Shtetit Islamik në të njëjtën kohë. Siguria e Shteteve të Bashkuara për mbështetjen e këtyre vendeve sunnite arabe, megjithatë, paraqet rrezikun se misioni kryesor në Siri do të jetë i shtrirë në dy drejtime të ndryshme. Shtetet e Bashkuara kanë për qëllim të dëmtojnë Shtetin Islamik pa synuar drejtpërdrejt presidentin sirian, Bashar al Assad. Shtetet sunnite arabe megjithatë duan të zhvendosin regjimin miqësor të al Assadit ndaj Iranit dhe të dobësojnë pozitën e grupit shiit militant Hezbollah bazuar te Libani, i cili po mbështet qeverinë siriane.

Rreziqet për kohezion

Nga ana e tyre, Australia dhe anëtarët europianë të koalicionit kanë një grup të ndryshëm interesash nga partnerët e tyre arabë. Për shkak se një numër i madh luftëtarësh të huaj së Shtetit Islamik e kanë origjinën në Europë, këto qeveri kanë frikë se militantët në një pikë mund të kthehen në shtëpi dhe të kërcënojnë sigurinë kombëtare. Shteti Islamik ka marrë gjithashtu edhe pengje europiane dhe vazhdon të jetë një burim për radikalizim brenda Europës. Kjo do të thotë se këto shtete kanë arsyetimet e nevojshme për kryerjen e sulmeve kundër Shtetit Islamik, pavarësisht zonës së tij të operacionit. Megjithatë, të gjitha nga gjashtë këto fuqi kanë zgjedhur të mos veprojnë mbi Sirinë pa një mandat të qartë nga Kombet e Bashkuara. Në vendet europiane, në veçanti, ndërhyrja ushtarake është një subjekt politik i ndjeshëm; miratimi për çdo lloj përfshirjeje të drejtpërdrejtë, zakonisht kërkon mbështetjen e parlamentit, duke vënë kufizime të ngushta zgjedhore në operacione të tilla. Këto kufizime janë më pak të ashpra në rastin e Irakut, ku koalicioni po jep asistencë për një popull mikpritës duke kërkuar ndihmë në vend të kryerjes së një ndërhyrjeje ushtarake në një vend pa koordinimin me qeverinë e tij.

Ndarja e koalicionit në dy zona të veçanta nuk do të kufizojë aftësitë ushtarake, por paraqet një rrezik serioz për kohezionin e tij dhe nga shtrirja, aftësinë e tij për të mbështetur operacionet efektive mbi Sirinë në veçanti. Për shkak të interesit direkt të shteteve arabe në rezultatin e luftës civile siriane, ata mund të përpiqen të nxisin Shtetet e Bashkuara në drejtim të zgjerimit të operacioneve ajrore së objektivave të regjimit të al Assad. Kjo është diçka që Shtetet e Bashkuara nuk janë të gatshme të bëjnë, pjesërisht se kjo do të kishte një kosto shumë më të lartë logjistike, por nëse një mosmarrëveshje e tillë do të kërcënonte operacionet mbi Sirinë, ngurrimi i europianëve për të zgjeruar aktivitetet e tyre në Siri do të kufizonte seriozisht koalicionin. Gjithashtu, Shtetet e Bashkuara do të rrezikojnë të perceptohen si i vetmi aktor në anën siriane të betejës e jo pjesë e një koalicioni ndërkombëtar dhe kjo mund të rezultojë në një nxitje të rëndësishme në terren. Në të njëjtën kohë, mosmarrëveshjet në fushën e operacioneve në Siri mund të ndrydhin efektivitetin e sulmeve duke kufizuar në minimum objektivin e vendosur për të cilin të gjitha palët mund të bien dakord.

Pra, koalicioni i udhëhequr nga SHBA-ja është i brishtë. Kur diçka është kaq delikate dhe e komplikuar, është vështirë të merret veprimi vendimtar që kërkohet për të degraduar dhe frenuar një kundërshtar të tillë dinamik, si Shteti Islamik.

Burimi: Stratfor



Akademia e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara

Akademia e Forcave Ajrore Shteteve të Bashkuara (USAFA ose Air Force Academy), është një akademi ushtarake e kandidatëve për oficerë për Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Kampusi i saj ndodhet menjëherë në veri të Kolorado Springs në El Paso County, Kolorado, Shtetet e Bashkuara. Misioni i deklaruar i Akademisë është "për të edukuar, trajnuar dhe të frymëzojë burrat dhe gratë që të bëhen oficerë të karakterit, të motivuar për të udhëhequr Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara në shërbim të kombit. Ajo është më i reja e shërbimit pesë Akademitë e Shteteve të Bashkuara, duke nxjerrë brezin e parë në vitin 1959 të të diplomuarve të programit katërvjeçar të Akademisë, të cilët marrin një diplomë Bachelor i Shkencave duke u titulluar si togerë në Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Akademia është gjithashtu një qendër nga më të mëdhatë turistike në Kolorado, që tërheq më shumë se një milion vizitorë çdo vit.

Kandidatët për pranim vlerësohen nga arritjet akademike të tyre, demonstrimeve drejtuese, atletikë dhe të karakterit. Për tu pranuar kandidatët duhet të kalojnë një test në palestër, i nënshtrohen një ekzaminim të plotë mjekësor, si dhe të sigurojnë një nominim, i cili zakonisht vjen nga anëtari i Kongresit nga zona e kandidatit. Normalisht regjistrohen rreth 1.200 kadetë dhe historikisht vetëm nën 1.000 të tyre diplomohen. Shkollimi së bashku dhe akomodimi paguhen të gjitha nga qeveria e SHBA. Kadetët marrin një pagë mujore, por angazhohen për të shërbyer një numër të viteve të shërbimit ushtarak pas diplomimit.

Programi në Akademinë udhëhiqet nga vlerat e Forcave Ajrore në bazë të "Integritetit, e para Shërbimi i Parë i Vetëvetes dhe Përsosmëri për të gjithë Ne" dhe në bazë të katër "shtyllave të përsosmërisë", trajnimit ushtarak, akademik, atletikë dhe zhvillimi i karakterit. Përveç një regjimi ushtarak rigoroz të trajnimit, kadetët gjithashtu marrin njohuri të gjera akademike, një kurs me një kurrikul bërthamë të gjerë në inxhinieri, shkencat humane, shkencat sociale, shkencat bazë, studimet ushtarake dhe edukimit fizik. Të gjithë kadet marrin pjesë në atletikë ose ndëruniversitar ose intramural, një zhvillim të karakterit dhe udhëheqje kurrikulumi të plotë që u siguron kadetëve një bazë për officership në të ardhmen. Secili nga komponentët e programit ka për qëllim t'i japë Kadetëve aftësi dhe njohuri që atyre do të duhet për suksesin si oficerë.

Njoftim për studime ushtarake në SHBA

Qendra e Personel Rekrutimit (QPR) kërkon të rekrutojë studentë ushtarakë për studime në Akademitë Ushtarake në SHBA, 6 (gjashtë) vende për çdo akademi. Afati kohor për dorëzimin e dosjeve pranë QPR është deri në 31 tetor 2014.

Akademitë janë:
- Westpoint, Neë York, SH.B.A.
- Akademia e Forcave Ajrore, Colorado, SH.B.A.
- Akademia e Forcave Detare/Marinsave, Annapolis, Maryland, SH.B.A.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:
- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të ketë kryer shkollë të mesme brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
- Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 22 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik.
- Të mos jetë i martuar.
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV dhe Hepatit B; të mos ketë kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit të kenë notën mesatare të gjitha viteve të shkollës së mesme jo më pak se 8.5 si dhe të kenë notën mesatare jo më pak se 8.5 veças për lëndët, matematikë, fizikë, kimi.
- Të zotëroj gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur, në bazë të testimit AL-CPT mbi 70 pikë, të zhvilluar nga Qendra e Gjuhëve të Huaja në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit në rast se:

a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk kane përfunduar studimet.

- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.
- Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (Akademia e Forcave të Armatosura), në zbatim të pikës 2.12 të verë në dispozicion të QPR-së të dhënat që administrojnë për kandidatët subjekt të pikave a, b dhe c.

2. Dokumentet për regjistrim:
Kandidati për regjistrim duhet të paraqesë pranë Zyrës së Rekrutimit Tiranë këto dokumente:
- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në SHBA, ku të specifikohet akademia për të cilën aplikohet dhe/ose të renditen akademitë që preferohen nga kandidati.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, ANEKSI A.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar që vërteton përfundimin e shkollës së mesme dhe listës së notave.
- Certifikatë për TOEFL, SAT ose ACT (nëse e ka).
- Dokument i cili vërteton se aplikanti është regjistruar për testimet që zhvillohen online TOEFL, SAT ose ACT. Data e zhvillimit të testimit nuk duhet të jetë më vonë se javën e dytë të muajit nëntor.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.
- Fotografi për dokument, 2 (dy) copë.
- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Vërtetim nga përmbarimi.
- Raport mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcës Tokësore ku shprehet nëse kandidati është i aftë për të ndjekur studimet ushtarake jashtë vendit.
- Analiza e SIDA-s.
- Vërtetimet mjekësore se kandidati nuk është bartës i virusit HIV dhe Hepatit "B" dhe që nuk ka kaluar sëmundje të zemrës, veshkave, mëlçisë dhe mushkërive.
- Fotokopje e pasaportës së vlefshme për jashtë shtetit.

3. Datat e testimit:
Testi Psikologjik: 05.11.2014
Testi Fizik: 07.11.2014 (të dhënat e testimit fizik)
Testi i Gjuhës së Huaj: 11.11.2014
Testi Intelektual: 13.11.2014

ÇMIMET NOBEL 2014

Çmimi Nobel në Fizikë 2014

ISAMU AKASAKI, HIROSHI AMANO DHE SHUJI NAKAMURA

"Për shpikjen e dritës blu efikase të emetuar nga diodat, e cila ka mundësuar kursimin e burimeve të dritës së bardhë dhe energjisë së shndritshme".

Çmimi Nobel në Kimi 2014

ERIC BETZIG, STEFAN W. HELL DHE WILLIAM E. MOERNER

"Për zhvillimin e super zgjidhjes së mikroskopisë fluo-reshente".

Çmimi Nobel në Fiziologji ose Mjekësi 2014

JOHN O' KEEFE, MAY-BRITT MOSER DHE EDVARD I. MOSER

"Për zbulimet e tyre të qelizave që përbëjnë një sistem të pozicionimit në tru".

Çmimi Nobel në Letërsi 2014

PATRICK MODIANO

"Për artin e memories me të cilën ai ka shkaktuar fa-tin më të pakapshëm të njeriut dhe ka zbuluar push-timin e jetës së botës".